



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Siguria dhe Hetimi”**

**Akademia e Sigurisë**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Jola BODE**

A blue ink signature of Prof. Asoc. Jola BODE.

**Dr. Bledar MUSTAFARAJ**

A blue ink signature of Dr. Bledar MUSTAFARAJ.

**Korrik / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Bachelor në "Siguria dhe Hetimi"**

1	IAL aplikues:	Akademia e Sigurisë
2	Njësia bazë që e ofron:	- Departamenti i Hetimit të Krimit - Departamenti i Ruajtjes dhe Sigurisë - Departamenti i Formimit të Vazhdueshëm - Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Juridik
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Siguria dhe Hetimi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 458, datë 27.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i I-rë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite/ 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	23 PAE / 8 PAK Ngarkesa mësimore 88 % PAE - 12 % PAK
18	Numri i studentëve:	- 2020-2021 - 70 studentë; - 2021-2022 - 96 studentë; - 2022-2023 - 95 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

*[Signature]*

*[Signature]*

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Akademia e Sigurisë (e përmendur në vijim me inicialet AS) është krijuar me VKM Nr. 184, datë 20.12.1971, në vijim të Shkollës së Ministrisë së Brendshme. Në vijim, AS është krijuar me VKM Nr. 185, datë 25.02.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”. Me Urdhërin Nr. 180, datë 15.04.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve është riorganizuar si institucion arsimor. Me VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”, kësaj Akademie i është dhënë status i veçantë si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Njësitë kryesore akademike të kësaj akademie janë:

1. Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit;
2. Kolegji Profesional i Formimit Policor;

Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit përbëhet nga:

1. Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Juridik;
2. Departamenti i Hetimit të Krimin;
3. Departamenti i Ruajtjes dhe Sigurisë;
4. Departamenti i Formimit të Vazhdueshëm;

Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”, objekt vlerësimi, ofrohet nga Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit. Në Akademinë e Sigurisë, fillimisht, janë zhvilluar programet e ciklit të parë të studimit, “Bachelor” “Për rendin dhe sigurinë publike” dhe Bachelor” “Për hetimin e krimin”. Me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 458, datë 27.07.2018, programet e studimit Bachelor “Për hetimin e krimin” dhe “Për rendin dhe sigurinë publike”, u riorganizuan në një program të përbashkët të quajtur Bachelor në “Siguria dhe hetimi”.

Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” është program i ciklit të parë të studimeve, i cili realizohet në 3 (tri) vite akademike, në 180 ECTS. Programi në fjalë është program në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.

Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe hetimi” synon të përgatisë specialistë të lartë për Sigurinë dhe Hetimin, të aftë për të shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit, në të gjitha funksionet operuese e menaxheriale; specialistë me kulturë e dije të nivelit universitar, me standarde të larta etike profesionale dhe njohës të mirë të ligjit, misionit dhe përgjegjësi institucionale të policisë; specialistë me aftësi praktike e shprehi aplikative në zotërimin e teknikave bashkëkohore të fushës së parandalimit e luftës kundër krimin dhe për menaxhimin e situatave të sigurisë publike (*Evidenca 13, neni 4*). AS ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”, ku me shkresën Nr. 197/1 Prot., datë 1.11.2022 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.

3

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht ([www.ascal.al/standardet](http://www.ascal.al/standardet)).

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Jola Bode, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert (të caktuar me urdhrin përkatës nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga znj. Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit në AS, të zhvilluar në datat 28-29 Mars 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga AS në ofrimin e një programi të mirë Bachelor në “Siguria dhe hetimi”. Gjithashtu, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

Akademia e Sigurisë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.06.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 45/6 Prot, datë 19.06.2023. Akademia e Sigurisë përcjell në ASCAL më datë 20.06.2023, me anë të shkresës me Nr. 1415/1 Prot, datë 20.06.2023, “Kthim përgjigje draft raportit të vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

4

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, ky program studimi është hartuar duke marrë parasysh kërkesat në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, në përputhje me nevojat e policisë së shtetit dhe të institucioneve të tjera në vend, traditën e IAL-së dhe ecurinë e proceseve integruese të vendit. Ky program, jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por i përçon ato tek brezi i ri.</p> <p>Konkretisht, programi i studimit Bachelor “Siguria dhe Hetimi” është në përputhje me interesat dhe synimet e vendosur në VKM Nr. 881, datë 28.10.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë të Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, të ndryshuar. Ky program studimi është në linjë me politikën kombëtare për përmirësimin dhe qasjen e shërbimeve të policisë së shtetit, si një sektor me rëndësi të madhe në veprimtarinë shtetërore, ndaj praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, përfshi dhe vendet e rajonit (<i>Evidenca 1, nenet 5 dhe 6; Evidenca 13, nenet 4 dhe 5</i>).</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me standardet e ndjekur jo vetëm nga shteti shqiptar në fushën e sigurisë dhe hetimit gjatë veprimtarisë policore e më gjerë, por të vendeve të BE-së në përgjithësi e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithashtu, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve me universitete dhe organizma të huaj, ky program ka aftësinë për të përmirësuar vlerat akademike ekzistuese në institucion (<i>Evidenca 2, pikat 3 dhe 4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të personave të punësuar në strukturat e policisë së shtetit dhe në institucione të tjera të zbatimit të ligjit, duke iu ofruar atyre një edukim cilësor, në partneritet me institucionet ndërkombëtare. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të plotë me sa më sipër dhe ofron një</p>

	shembull pozitiv se si tradita akademike dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mund të ndërthuren në një program studimi ( <i>Evidenca 1, nenet 5, 7; Evidenca 13, nenet 4, 5</i> ).
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Bazuar në statutin e AS, rregulloren institucionale si dhe Strategjinë Zhvillimore të saj, programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me këta dokumente si dhe në zbatim të tyre. Një nga objektivat e institucionit është ruajtja dhe avancimi i profilit të tij kryesor, si p.sh., në fushën e sigurisë publike, e cila është edhe një nga prioritetet në fushat dhe drejtimet kryesore të kërkimit shkencor. Ky program studimi është në përputhje me këtë objektiv dhe e çon përpara atë (<i>Evidenca 2, pikat 3 dhe 4</i>).</p> <p>Programi i studimit ofrohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e përgjithshme të IAL-së. Bazuar në strategjinë zhvillimore të AS si dhe në strategjinë për veprimtari kërkimore dhe zhvillimore, programi i studimit synon të formojë dhe kualifikojë punonjësit e institucioneve ligjzbatuese të rendit dhe sigurisë, por dhe kryerjen e studimeve të karakterit teoriko-shkencor në fushën e rendit dhe sigurisë publike. Programi është reflektim dhe mishërim i prioriteteve të përcaktuar në statutin dhe rregulloren e AS (<i>Evidenca 1, nenet 5 dhe 7</i>).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” është i përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të parë si nga forma, përmbajtja ashtu dhe shtrirja kohore. Ky program studimi ka një ngarkesë prej 180 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 3 vitesh (6 semestra) dhe emërtimi i tij është i përshtatshëm për disiplinën në fushën e sigurisë dhe rendit me theks të veçantë edhe në procesin hetimor (<i>Evidenca 13, neni 6</i>). Ky program studimi është në përputhje dhe vazhdimësi me një nga fushat e drejtimit akademik të institucionit, atë të sigurisë dhe hetimit, në përputhje me sa përcaktur në VKM Nr. 881/2020, të ndryshuar, si dhe aktet themelore të IAL-së (<i>Evidenca 1, nenet 5 dhe 18</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>AS ka një përvojë të gjatë në fushën e studimit specifik dhe të kualifikimit të punonjësve të policisë së shtetit, duke nisur që nga viti 1971, me përfshirjen e stafit akademik, studiuesve dhe personaliteteve të kualifikuara dhe me përvojë. Akademia e Sigurisë është institucioni i vetëm në Shqipëri për të ofruar këtë program studimi. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i përshtatshëm dhe i kualifikuar. Aktualisht ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Sigurisë dhe i Hetimit, por në mësimdhënie është i angazhuar i gjithë stafi i Akademisë</p>




	<p>si dhe staf me kohë të pjesshme. Stafi akademik i angazhuar është i kualifikuar me grada shkencore dhe tituj akademikë si dhe nga specialistët më të mirë të fushës (<i>Evidenca "Aneks, tabelat 1 dhe 2; Evidenca 8).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të Akademisë së Sigurisë. Kjo Akademi është e dedikuar për studimet në fushën e rendit dhe të sigurisë publike dhe ofrimi i këtij programi studimi është tërësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore. Ky program është në përputhje me VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, me statutin dhe aktet e tjera rregullatore të AS-së (<i>Evidenca 1; Evidenca 13)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Programi i studimit është hartuar duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e policisë së shtetit dhe të institucioneve të tjera në vend, traditën e IAL-së dhe ecurinë e proceseve integruese të vendit, dhe është në përputhje me interesat kombëtare.</i></li> <li>- <i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e Akademisë së Sigurisë, për formimin akademik të personave të punësuar në strukturat e policisë së shtetit dhe në institucione të tjera të zbatimit të ligjit si dhe në përputhje të plotë me aktet e brendshme rregullatore të akademisë.</i></li> <li>- <i>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i përshtatshëm dhe i kualifikuar.</i></li> <li>- <i>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të Akademisë së Sigurisë. Ky program është në përputhje me VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, me statutin dhe aktet e tjera rregullatore të AS-së.</i></li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 25%; text-align: center;"><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td style="width: 25%; text-align: center;"><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td style="width: 25%; text-align: center;"><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> </table>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>		


*Arledina*

*JH*

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në Akademinë e Sigurisë u vu re se anëtarët e stafit ishin dashamirës, bashkëpunues dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Në tërësi, ata vinin nga përvoja të gjata pune në strukturat e policisë së shtetit, pra profesionale, gjithashtu dhe akademike, gjë që mundëson një bashkëpunim profesional dhe të frytshëm. Nga pikëpamja rregullatore, AS ka miratuar statutin dhe rregulloren e saj, ku rregullohen proceset e brendshme. Gjithashtu, nëpërmjet strukturave të ngritura, AS ka vënë në jetë procedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë. Çdo anëtar i stafit, në fund të vitit akademik, plotëson formularin me aktivitetin akademik dhe profesional dhe dorëzon një plan për vitin e ri. Ky dokumentacion përbën bazën e vlerësimit të punës, ndarjes së detyrave dhe planifikimit të veprimtarive (<i>Evidenca 1; Evidenca 3; Evidenca 60, neni 9</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe nga vizita në institucion rezulton që AS ka vendosur bashkëpunime kryesisht me institucione qendrore dhe lokale publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e rendit dhe sigurisë publike (<i>Evidenca 6.1</i>). Përsa i përket marrëdhënieve me jashtë, AS ka lidhur marrëveshje me akademi dhe shkolla të tjera si motra nga vende anëtare të BE-së dhe të rajonit si dhe me struktura të tilla si CEPOL dhe FRONTEX, të cilat mundësojnë dhe krijojnë kushtet e përshtatshëm për të arritur synimet e vendosur për këtë program studimi si dhe përmirësuar procesin e formimit të studentëve (<i>Evidenca 6</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave</p>	<p>Siç është përmendur edhe me sipër, institucioni ka bashkëpunime të strukturuar me institucione publike qendrore kryesisht për zbatimin e praktikave studentore, por edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Praktikrat zhvillohen sipas kalendarit akademik, nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat e policisë së shtetit, ku realizohen ato, pasi praktika profesionale për këtë institucion ka si specifike kryerjen e tyre në policinë e shtetit (<i>Evidenca</i></p>






<p>profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>13, neni 38). Këto bashkëpunime lehtësohen edhe më tej nga fakti që disa nga lektorët e programit vijnë nga bota profesionale, pikërisht nga policia e shtetit, ku kanë mbajtur pozicione të larta drejtuese. Një tjetër element që e lehtëson punën e institucionit, është se një pjesë e studentëve të programit janë të punësuar, para se të regjistrohen në të (Evidenca 7; Evidenca 7.1).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në institucion, u vu re se Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit ka kryer në mënyrë periodike vlerësime lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit (Evidenca 5).</p> <p>Marrëveshjet përgjithësisht kanë rezultuar eficente, me përjashtim të ndonjëres prej tyre, kryesisht me IAL të tjera, e cila mund të jetë ndërprerë për shkak të mospasjes efektivitet të tyre (Evidenca shtesë "Takimi në institucion").</p> <p><u>GVJ gjen të arsyeshme të sugjerojë që, analizat lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit të përfshihen në planin e punës së NJSBC-së.</u></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni, nëpërmjet akteve të brendshme rregullatore, ka siguruar mbarëvajtjen e proceseve të brendshëm të veprimtarisë së Akademisë, ku secili anëtar ka të ndara qartë detyrat dhe përgjegjësitë si dhe kontribuon po ashtu në procesin e sigurimit të cilësisë. Kjo pasqyrohet dhe në frymën e bashkëpunimit midis anëtareve të personelit të këtij institucioni.</li> <li>- AS ka vendosur bashkëpunime me institucione qendrore dhe lokale publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e rendit dhe sigurisë publike si dhe me institucione homologe të huaja.</li> <li>- Institucioni ka të rregulluar mirë procesin e kryerjes së parkatikave profesionale, të cilat për shkak të specifikës së tij, kryhen në strukturat e policisë së shtetit.</li> <li>- Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, si pjesë përbërëse e AS, ka kryer në mënyrë periodike vlerësime lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit. <u>Sugjerohet që analizat lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit të përfshihen në planin e punës së NJSBC-së.</u></li> </ul>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” e përmbush këtë kriter, pasi është program i ciklit të parë, i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma bachelor. Programi ka 180 ECTS, zhvillohet në tri vite akademike të ndarë në 6 semestra dhe zbaton përcaktimet ligjore që burojnë nga legjislacioni i arsimit të lartë. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij dhe reflektojnë kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin ( <i>Evidenca 13, kreu V; Evidenca 8, pjesa II</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të	Programi ka për objektivi të përgatisë specialistë të lartë për Sigurinë dhe Hetimin, të aftë për të shërbyer në strukturat e policisë së shtetit, në të gjithë funksionet operuese dhe menaxheriale, specialistë me dije të nivelit universitar, njohës të mirë të ligjit, misionit dhe përgjegjësisive institucionale të policisë, specialistë me aftësi praktike e shprehi aplikative në zotërimin e teknikave bashkëkohore të fushës së parandalimit dhe luftës kundër krimit dhe për menaxhimin e situatave të sigurisë publike. Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale specifikisht në strukturat e policisë së shtetit, pasur parasysh natyrën e veçantë të Akademisë së Sigurisë, të

përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

cilët duhet të njohin strukturat/aktet rregullatore të këtij sektori të veprimtarisë shtetërore, dhe harmonizohen gradualisht me to. Gjithashtu, programi u mundëson studentëve të cilët kanë interes të vijojnë ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formues të programit të studimit (*Evidenca 13*).

Specifikisht, ky program studimi synon:

- a. Përgatitjen e punonjësve profesionistë të policisë në fushën e rendit, sigurisë publike dhe luftës ndaj krimit;
- b. Të plotësojë nevojat e policisë së shtetit për resurse të aftë profesionalisht dhe specialistë me nivel të lartë kulturor, të përputhur me zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit;
- c. Ngritja e kapaciteteve të formimit policor duke respektuar angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollës shqiptare të policisë dhe shkollave më të mira perëndimore, në kuadër të angazhimit dhe integritit në BE;
- d. Studentët të fitojnë elementet bazë dhe shprehite e punës kërkimore studimore si objektiv i posaçëm i studimeve akademike nëpërmjet hapave përkatës të parashikuar në program;
- e. Të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit sociologjik, psikologjik, juridik, etj, si dhe të realizojë thellimin e njohurive që përkojnë me profilin e diplomës për Sigurinë dhe Hetimin, duke vendosur objektiva specifike për përgatitjen e ekspertëve të policisë për të operuar në të gjitha fushat e shërbimit policor.

Në tërësi lëndët dhe syllabus-et reflektojnë mirë këto objektiva në literaturën që japin për studentët, detyrat përkatëse si dhe veprimtaritë në klasë. Përditësimi në kohë reale i teksteve bazë është shumë i rëndësishëm, pasi është një fushë që ndryshon shumë shpejt. Gjithsesi, GVJ e mirëkupton vështirësinë dhe kostot e qenësishme të përkthimit në kohë të literaturës (*Evidenca 13; Evidenca 8, pjesa III*).

Sa thënë më lart, programi i studimit iu ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca teorike dhe praktike në fushën e sigurisë dhe hetimit. Në tërësi, në këtë program studimi studentit i mundësohet përvetësimi i njohurive të thelluara dhe aftësimi profesional me qëllim përshtatjen, sa më shumë të jetë e mundur, me nevojat e punës në strukturat e

	ndryshme policore si dhe zhvillimet e vendit ( <i>Evidenca 13; Evidenca 8</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Ky program organizohet në module/lëndë me kredite ECTS dhe lëndët grupohen sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, të ndryshuar, si vijon:</p> <p>A. Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme – 8 lëndë, 32 kredite ECTS (17,8 % e totalit të krediteve);</p> <p>B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik – 14 lëndë, 93 kredite ECTS (51,6 % e totalit të krediteve);</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje – 6 lëndë, 26 kredite ECTS (14,5 % e totalit të krediteve);</p> <p>D. Lëndë plotësuese - praktikat profesionale – 5 lëndë, 23 kredite ECTS (12,7 % e totalit të krediteve të këtij programi);</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës – 6 kredite ECTS (3,4 % e totalit të krediteve) (<i>Evidenca 13, nenet 7, 21, 22; Evidenca 8, pjesa II, pika 8 "Struktura e planit mësimor. Elementet përbërës të tij"</i>).</p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Programi i studimit ka 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 3 vite akademike sipas detyrimeve ligjore. Sipas elementeve të këtij programi, praktika profesionale është e përfshirë në kategorinë "B" të lëndëve me ngarkesë prej 4 kredite dhe në kategorinë "D" me ngarkesë 7 kredite ECTS. Praktika është proces mësimor, gjatë së cilës caktohet një mbikëqyrës në terren dhe zgjat dy javë. Gjatë saj, studentëve iu jepet mundësia që të qarkullojnë në të gjithë sektorët e policisë së shtetit dhe në fund vlerësohet me notë. Gjithashtu, detyrimet përmbyllëse që lidhen me provimin e diplomës, kanë 6 kredite ECTS ose deri 5% të krediteve. Në Rregulloren e programit, parashikohet si provë finale punimi i një diplome ose provimi i përgjithshëm përfundimtar, që është kontrolli i dijeve në kuadër të formimit të marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Bachelor (<i>Evidenca 13, nenet 7, 21, 38 dhe kreu VIII; Evidenca 8, pjesa II</i>).</p>
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet	<p>Programi i studimit Bachelor në "Siguria dhe Hetimi" është i organizuar në aspektin strukturor dhe akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe për shkak të specifikës së tij edhe në harmoni me</p>

<p>e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>parashikimet e VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar. Forma e organizimit të studimeve është e përcaktuar dhe e detajuar në Rregulloren e programit si dhe në dokumentin që bën fjalë për programin e studimit, objekt vlerësimi (<i>Evidenca 13; Evidenca 8</i>).</p> <p>Mënyra e pranimit të studentëve është përcaktuar në rregulloren e këtij program studimi dhe është detajuar në aktet e tjerë të brendshëm të Akademisë (<i>Evidenca 13, neni 10; Evidenca 10; Evidenca 10.1</i>). Ky program studimi është i organizuar me 180 ECTS, në tri vite akademike, në formën e studimeve me kohë të plotë, ku në fund të studimeve lëshohet diploma e ciklit të parë të studimeve (sipas modelit të miratuar nga MAS) (<i>Evidenca 13, neni 45; Evidenca shtesë 3</i>).</p> <p>Sa i përket financimit, në bazë të pikës 29 të VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, AS financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme; akademja është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të policisë së shtetit, gjë e cila është pasqyruar dhe në statutin e saj (<i>Evidenca 1, kreu X</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi (<i>sipas GVB-së, f. 7</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” është program i ciklit të parë të studimeve, në nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Lëndët në programin e studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” janë të shoqëruara me kodin përkatës, sipas germave dhe numrave të përcaktuara/miratuara në aktet nënligjore nga ministria përkatëse (<i>Evidenca 8, pjesa III “Syllabuset e lëndëve”</i>).</p> <p>Nga dokumentacioni rezulton që programi, objekt vlerësimi, është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke marrë numrin unik të identifikimit PS8616180204 (<i>Evidenca 11</i>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi, pasi programi “Siguria dhe Hetimi” është program unik që zhvillohet në</p>





përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	shtetin shqiptar, sipas nevojave dhe kërkesave të policisë së shtetit. (GVJ, f. 7).			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit Bachelor në "Siguria dhe Hetimi" është program i ciklit të parë, i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma bachelor.</li> <li>- Programi ka 180 ECTS, zhvillohet në tri vite akademike të ndarë në 6 semestra dhe zbaton përcaktimet ligjore që burojnë nga legjislacioni i arsimit të lartë. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij dhe reflektojnë kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</li> <li>- Programi synon të përgatisë specialistë të lartë për Sigurinë dhe Hetimin, të aftë për të shërbyer në strukturat e policisë së shtetit, në të gjithë funksionet operuese dhe menaxheriale, specialistë me dije të nivelit universitar, njohës të mirë të ligjit, misionit dhe përgjegjësive institucionale të policisë, specialistë me aftësi praktike e shprehi aplikative në zotërimin e teknikave bashkëkohore të fushës së parandalimit dhe luftës kundër krimit dhe për menaxhimin e situatave të sigurisë publike.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Përsa i përket këtij kriteri, GVJ vë në dukje që AS është një institucion i veçantë, i krijuar nëpërmjet VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, me fokus kryesor përgatitjen e




<p>përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>specialistëve të lartë për strukturat e policisë së shtetit. Organizimi i AS bazohet në VKM-në e përmendur më lart, legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, statutin e saj dhe aktet e tjera nënligjore. Aktualisht AS në strukturë ka 2 njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit;</li> <li>2. Kolegji Profesional i Formimit Policor;</li> </ol> <p>Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit përbëhet nga 4 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Ruajtjes dhe Sigurisë;</li> <li>2. Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Juridik;</li> <li>3. Departamenti i Formimit të Vazhdueshëm;</li> <li>4. Departamenti i Hetimit të Krimit;</li> </ol> <p>Duke qenë që ky statut është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, GVJ e vlerëson organizimin e njësisë kryesore në përmbushje të detyrimeve ligjore (<i>Evidenca 1, neni 18; Evidenca 13; Evidenca 2</i>).</p> <p>AS i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 7, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.01.2028.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në program përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme me tituj akademikë e grada shkencore. GVJ vëren se stafi akademik i përfshirë në realizimin e programit është me formimin e duhur, me grada e tituj dhe, bazuar në takimin e zhvilluar me studentët, profesional e i disponueshëm.</p> <p>Për shkak të specifikës së AS, referuar përmbajtjes së pikës 15 të VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, personeli akademik me gradë policore përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit, kurse personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese përzgjidhet nga radhët e punonjësve të këtyre strukturave; në të dy rastet sipas kriterëve të përcaktuar në statutin e AS dhe emërohet nga rektori. Për personelin akademik me gradë policore ose gradë sipas statutit të strukturave përfituese, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet ekuivalentimi i këtyre gradave me gradat shkencore dhe titujt akademikë të personelit akademik.</p> <p>Nga të dhënat e tabelave të RVB rezulton se Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit për vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga 28 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 22 Personel</p>
--	---




Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	3
Prof.Asoc	6	4
Dr/PhD	16	5
Msc	4	10
<b>Gjithsej</b>	<b>28</b>	<b>22</b>

Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezulton se çdo njësi bazë e Fakultetit plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor. Të katërt Departamentet si njësi përgjegjëse për programin e studimit referuar dokumentit (*RVB tabelave dhe Personeli akademik-Departamenti i Formimit të Vazhdueshëm 2022-2023*) në vitin akademik 2022-2023 kanë këtë paraqitje:

**Departamenti i Formimit të Përgjithshëm Juridik:**

- 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;
- 9 PAK, ndër të cilët, 7 me tituj / grada;

**Departamenti i Hetimit të Krimin:**

- 7 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada;
- 5 PAK, ndër të cilët, 0 me tituj / grada;

**Departamenti i Ruajtjes dhe Sigurisë:**

- 7 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada;
- 1 PAK, ndër të cilët, 1 me titull / grada;

**Departamenti i Formimit të Vazhdueshëm:**

- 7 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada;
- 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;

Në rastet kur janë angazhuar personel i kategorisë “Asistent lektor”, me diplomë “Master i Shkencave” që zhvillojnë veprimtari mësimore e kërkimore, është realizuar në përputhje me parashikimet statutorë, me kohëzgjatje të përcaktuar (*Evidenca 1, neni 30; Evidenca 13, kreu IX*).

Personeli policor i përfshirë në mësimdhënie, shërben vetëm për lëndët profesionale, por paraqet si problematikë faktin e lëvizjes së tyre në mënyrë të vazhdueshme (*Evidenca shtesë “Shënime në institucion-takim me stafin akademik”*).



	<p>Në tërësi, GVJ vëren se AS ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. Në aktet e brendshme janë të rregulluara detyrat e njësisë kryesore dhe asaj përgjegjëse lidhur me vlerësimin dhe akreditimin (<i>Evidenca 1, kreu IX; Evidenca 3.1, Evidenca 48; Evidenca 60</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësitet bazë, pranë të cilëve ofrohet dhe ky program studimi, janë të organizuara në aspektin strukturor-akademik, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Pjesë e njësisë kryesore është dhe stafi ndihmës-akademik dhe administrativ, detyrat e të cilëve janë të përcaktuara në statut dhe në rregulloren e përgjithshme të institucionit (<i>Evidenca 1, nenet 33-34; Evidenca 3, kreu IV</i>).</p> <p>Për shkak të veprimtarisë së AS dhe të programit në veçanti, me fillimin e vitit të fundit akademik, departamentet iu bëjnë me dije studentëve programin e praktikës, drejtuesit e grupeve të përzgjedhur nga stafi mësimdhënës për drejtimin e praktikës, vendet e planifikuara për zhvillimin e saj si dhe kohën e kryerjes. Gjatë kryerjes së praktikës, pedagogu që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me strukturën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport për punën e kryer, e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën. Për praktikën e zhvilluar krijohet një dosje, ku evidentohet ecuria e studentit në të gjitha fazat e praktikës. Strukturat ku zhvillohet praktika japin mendim me shkrim për vlerësimin e studentit, të cilat i bashkëngjiten dosjes së studentit. Për zhvillimin sa më normal dhe sa më eficient të praktikës nga Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, hartohet një plan i veçantë në bashkëpunim me AS-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, në të cilin përcaktohen qartë të gjitha detyrimet e studentëve, komisariateve ku do të kryhet praktika dhe stafit akademik që do të ndjekë zhvillimin e praktikës (<i>Evidenca 13, neni 38</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në</p>	<p>Sipas <i>RVB, f. 7</i>, është njësia kryesore, fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, ajo e cila ka përgjegjësinë për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vetë programit. Duke qenë se është programi i vetëm që ka kjo njësi kryesore, nuk ka një koordinator të veçantë, i cili të përmbushë këto detyra. Nga aktet del në pah se koordinator ka të parashikuar vetëm në programet e trajnimit (<i>Evidenca 3.1, pjesa e katërt</i>). Pavarësisht këtij fakti dhe mospasjes së problemeve deri më tani në këtë drejtim, në respektim të këtij kriteri, <i>GVJ sugjeron që nga ana e institucionit dhe njësisë kryesore e asaj bazë, të merren masat</i></p>






përputhje me objektivat e tij.	<i>e nevojshme me qëllim caktimin e një koordinatori të programit të studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Njësia kryesore (Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit), pranë të cilit ofrohet programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”, përbëhet nga tre njësi bazë, të cilat drejtohen nga drejtuesit përkatës. Detyrat dhe funksionet e tyre janë të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit.</i></li> <li>- <i>Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesve janë në funksion të procesit mësimor dhe të cilësisë së njësive përkatëse.</i></li> <li>- <i>Personeli akademik i angazhuar në program përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme me tituj akademikë e grada shkencore. Për personelin akademik me gradë policore ose gradë sipas statutit të strukturave përfituese, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet ekuivalentimi i këtyre gradave me gradat shkencore dhe titujt akademikë të personelit akademik.</i></li> <li>- <i>Në programin e studimit njësia kryesore angazhon personel ndihmës akademik e administrativ, në përputhje me parashikimet e akteve të brendshme rregullatore të Akademisë.</i></li> <li>- <i>GVJ sugjeron që njësia kryesore ku ofrohet ky program, të caktojë një koordinator të programit të studimit, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për	AS është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, që gëzon status të veçantë, e krijuar në vitin 1971, që ka pësuar riorganizime ndër vite. Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se AS zotëron informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit.

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit, bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, të ndryshuar, ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kreditet ECTS;</li> <li>- kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>- objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>- veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>- kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>- planin mësimor;</li> <li>- kuotat e pranimi;</li> <li>- programin lëndor;</li> <li>- profilin e programit;</li> <li>- diplomën dhe suplementin.</li> </ul> <p>Për gjithë sa më sipër, GVJ vëren se ky kriter plotësohet (<i>Evidenca 13</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor është ndërtuar në përputhje me kriteret e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, të ndryshuar. Në planin mësimor detajohen lëndët, të ndara sipas kategorive formuese si dhe në vite e semestra, dhe kreditet përkatës. Plani detajon gjithashtu ngarkesën mësimore, orët në dhe jashtë auditorit, frekuentimin e lëndëve dhe vlerësimin e dijeve.</p> <p>Programi i studimit i përket ciklit të parë dhe organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione, seminare, punim esesh, detyrash apo projektsh, prezantime, provime, përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës ose e provimit të diplomës, praktika profesionale. Elementet janë të sqaruar mirë dhe sigurojnë informacionet e duhura për studentët dhe aktorët e tjerë të përfshirë në program (<i>Evidenca 8; Evidenca 13</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij, bazuar në kriteret ligjore, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimi dhe transferimit, të cilët janë bërë dhe publikë. Kuotat e pranimi të kandidatëve për studentë, për programin e studimit në fjalë, sipas pikës 22 të VKM Nr. 881, datë 28.10.2020, të ndryshuar, përcaktohen mbi bazën e nevojave të institucioneve të interesuara dhe kapaciteteve të Akademisë. Varësisht këtyre kuotave, AS pranon transferime nga IAL të tjera vendase ose të huaja. Njohja e plotë ose e pjesshme e krediteve realizohet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i cili ngrihet me propozim të departamenteve dhe urdhër të dekanit, bazuar në rregulloren e</p>

*[Signature]*

*[Signature]*

	programit dhe të institucionit ( <i>Evidenca 3; Evidenca 13, kërret III dhe IX; Evidenca 37; Evidenca 40</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Kriteri 4 plotësohet pasi, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në institucion, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikat dhe seminarët. Për syllabuset dhe praktikat respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, të ndryshuar. Për praktikat, AS ka miratuar formularin specifik të vlerësimit të praktikës ( <i>Evidenca 13; Evidenca 8; Evidenca 23; Evidenca 23.1</i> ).
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Institucionit i lejohet që, deri në masën 20% të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit të ndërmarrë ndryshime ( <i>Evidenca 1, neni 9, pika 17</i> ).  Bazuar në dokumentacionin e dërguar, por edhe nga vizita në institucion, ndryshime të tilla ka pasur në vitin 2021, për sezonin akademik 2021-2024. Në fillim të çdo viti akademik syllabuset përditësohen, ku vetë pedagogu mund të kryejë ndryshime deri në 8% të lëndës duke pasur për bazë reflektimet e veta, sondazhet e studentëve si dhe mendimet e dhënë nga alumni-t. Ndryshimet që pësojnë syllabuset varen së tepërmi nga përditësimi ose miratimi i akteve ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e policisë së shtetit. Siç jemi shprehur më sipër, kujdes i veçantë duhet bërë me përditësimin e literaturës pasi është një fushë që ndryshon shumë shpejt ( <i>Evidenca 13, neni 9; Evidenca 14; Evidenca 14.1; Evidenca 5; Evidenca shtesë 10; Evidenca shtesë "Shënime në institucion – takimi me stafin akademik</i> ).
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i>  <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Programi i studimit Bachelor në "Siguria dhe Hetimi" është i strukturuar dhe organizuar, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë si dhe në aktet e brendshme të institucionit.</i></li> <li>- <i>Programi ka strukturë akademike të organizuar në bazë të krediteve ECTS. Përmbajtja e lëndëve të kurrikulës është në funksion të formimit të thelluar profesional të studentëve në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.</i></li> </ul>

*Arta M. Mustafa*

*[Signature]* 20

	- Programi rishikohet në mënyrë periodike, në mënyrë të përgjithshme dhe në pjesë të veçanta, mbi bazën e reflektimeve individuale të pedagogëve, mendimeve të studentëve dhe alumni-t si dhe ndryshimeve në aktet ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e policisë së shtetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ vëren se emërtimi i programit është i përshtatshëm me përmbajtjen dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktika mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe aftësimin e studentëve në fushën e rendit dhe të sigurisë publike. Siç kemi thënë edhe më sipër, lëndët e programit dhe syllabusët janë të krahasueshme me programe të ngjashme në vende të BE-së dhe rajonit dhe iu ofrojnë studentëve mundësinë të fitojnë aftësi formuese dhe profesionale që t'i bëjnë ata të përshtatshëm për strukturat e policisë së shtetit, ku ata punësohen ( <i>Evidenca 8, pjesa I; Evidenca 15</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ vëren që lëndët dhe shpërndarja e tyre iu mundësojnë studentëve pajisjen dhe zbatimin në praktikë të aftësive metodologjike dhe njohurive teorike, të cilat përdoren gjatë punës së tyre me pas në strukturat e policisë së shtetit. Gjithashtu, përfshirja në veprimtari studentore është një element më shumë i aftësimit metodologjik në praktikë. Të gjitha këto elemente, së bashku, lehtësojnë procesin e mësimnxënies si dhe integrimin e plotë të studentëve në vendet e tyre të punës ( <i>Evidenca 13, neni 5; Evidenca 5</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe	Programi i studimit Bachelor në "Siguria dhe Hetimi" është strukturuar në bazë të orëve që zhvillohen në auditor në formën e leksioneve dhe seminareve dhe orëve të punës së pavarur. Shpërndarja e ngarkesës akademike për studentët është e balancuar përgjatë semestrave të secilit vit akademik. Përgjatë

<p>e përfaqësuar me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>një viti akademik janë shpërndarë 60 ECTS. Në program është parashikuar realizimi i praktikës profesionale dhe detyrimi përmblyllës. Nga ana e institucionit vihet në dukje se programi është konceptuar duke marrë si shembuj modele të ngjashme nga institucione të arsimit të lartë kombëtar, por dhe nga akademi policore të huaja, për të siguruar qasjet më të mira në këtë fushë. Në këtë kuptim, GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të ngjashme ndërkombëtare (<i>Evidenca 8</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në këtë program studimi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese teorike dhe praktike. Këto veprimtari janë të shpërndara përgjatë të gjashtë semestrave akademikë. Qëllimi i përmbajtjes së lëndëve është formimi teorik dhe praktik i studentëve. Njësi bazë ka rishikuar dhe përmbajtjen e kurrikulës për ta lidhur atë më shumë me sektorët ku punësohen studentët dhe ofrimin e njohurive të thelluara teorike. Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ vuri re se në leksione përdorej gjerësisht metoda ‘case study’ në leksion, e cila mundësonte gërshetimin e teorisë me situata praktike (<i>Evidenca 8; Evidenca shpeshë “Shënime në institucion – takimet me stafin akademik dhe studentët”</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Çdo lëndë ka syllabusin e saj, i cili përditësohet mbi bazën e zhvillimeve në legjislacionin që normon veprimtarinë e policisë së shtetit, propozimeve të titullarit, diskutimeve në departament si dhe sugjerimet e studentëve dhe të të diplomuarve. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se ata bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve. Në takim, nga stafi akademik u referua se tekstet që përdoren janë: tekstet bazë juridike, përmbledhje dispencash për lëndët bazë policore, botime të disa pedagogëve (p.sh. “Kriminalistika”). Akademia ka një fond shumë të vogël për botimet e pedagogëve, pasi buxheti i saj është i përfshirë në atë të policisë së shtetit (<i>Evidenca 8, pjesa III; Evidenca shpeshë “Shënime në institucion – takimi me stafin akademik”</i>).</p> <p><i>GVJ sugjeron që stafi akademik të botojë tekste akademike në funksion të programit të studimit, pasi në këtë profil nuk ka shumë literaturë në gjuhën shqipe.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në analizën e kriterëve të mësipërm, GVJ vëren se edhe ky kriter përmbushet, pasi në tërësi është rrjedhojë e tyre. Nga analiza sidomos e syllabuseve, GVJ vëren se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumenteve të vlerësimit. Të gjitha këto përputhen me objektivat e programit</p>

*Arben Ahmeti*

*AV* 22

	dhe strategjinë e vetë Akademisë, duke mundësuar përfitimin e dijeve të një programi të ciklit të parë ( <i>Evidenca 2; Evidenca 8, pjesa III; Evidenca 13</i> ).			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sipas dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, të ndryshuar, diplomimi nga një program Bachelor i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të dytë dhe të tretë. Ky program studimi duke ofruar edhe trajnim të avancuar në metoda kërkimi, i përgatit studentët për ciklin e dytë të studimeve si dhe për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. Përsa i përket tregut të punës, programi përgatit studentë, të cilët punësohen në strukturat e policisë së shtetit ( <i>Evidenca 13, neni 5, germa g; Evidenca 3.1, neni 70; Evidenca 8, pjesa III</i> ).			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Programi i studimit Bachelor në "Siguria dhe Hetimi" përmban lëndë, të cilat mundësojnë një formim të thelluar në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, duke nxitur aftësimin profesional të të diplomuarve.</i></li> <li>- <i>Në këtë program studimi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese teorike dhe praktike të shpërndara përgjatë të gjashtë semestrave akademikë. Qëllimi i përmbajtjes së lëndëve është formimi teorik dhe praktik i studentëve. Njësia bazë ka rishikuar dhe përmbajtjen e kurrikulës për ta lidhur atë më shumë me veprimtarinë e policisë së shtetit, sipas nevojave të kësaj të fundit, dhe ofrimin e njohurive të thelluara teorike si dhe aftësive praktike.</i></li> <li>- <i>GVJ rekomandon që stafi akademik duhet të mbështetet më shumë nga strukturat përkatëse akademike për botimin e teksteve në funksion të programit të studimit, pasi në këtë profil nuk ka shumë literaturë në gjuhën shqipe.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
		X		

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

*Abel Ahmeti*

*[Signature]*

<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>AS ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, kryesisht të institucioneve publike qendrore. Në përmbajtjen e programit të studimit, për shkak të specifikës së tij dhe natyrës së Akademisë, reflektohen dhe propozimet e strukturave të policisë së shtetit, të profilizuara sipas drejtimeve që ka veprimtaria formuese e njësisë kryesore që ofron këtë program. Nga bashkëpunimi me to, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave që këto struktura paraqesin. Gjithashtu, njësia kryesore ka mundësinë e bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare si BE, OSBE, etj., por dhe me misione të bashkëpunimit policor, të tillë si PAMECA, FRONTEx, MAPE, ICITAP, CEPOL, etj. (<i>Evidenca 5; Evidenca 14; Evidenca 14.1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët u vumë në dijeni se ata kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre për programin e studimit, literaturën në dispozicion si dhe qasjen didaktike. Studentët vlerësonin natyrën joformale të qasjes së AS, e cila i ndihmonte ata në komunikimin me pedagogët (<i>Evidenca shitesë "Shënime në institucion - takimi me studentët"; Evidenca 60, pjesa IV; Evidenca shitesë 13</i>).</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se AS ruan kontaktet me studentët e diplomuar dhe i kontakton në mënyrë të herëpashershme ata, për t'i gjurmuar si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Bashkëpunimi konsiston sidomos edhe në drejtim të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Ata japin mendimet e tyre sa i përket rishikimit dhe përmirësimit të kurrikulave, duke marrë në konsideratë vlerën e dijeve të marra gjatë programit, në raport me veprimtaritë që ushtrojnë në strukturat e policisë ku janë punësuar pas diplomimit (<i>Evidenca 16; Evidenca 16.1; Evidenca 16.2; Evidenca Evidenca 16.3; Evidenca 16.4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se AS ka të dokumentuar veprimtarinë e njësisë përgjegjëse që ofron këtë program studimi, në funksion të përmirësimit të tij në përputhje me standardet. Vëmendje e veçantë i është kushtuar kontakteve me grupet e interesit dhe faktorët institucionalë bashkëpunues për marrjen e mendimeve, vlerësimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet më themelore që lidhen me elementet e programit. Duke pasur gjithnjë në vëmendje natyrën specifike të programit, vërehet se është marrë mendimi i aktorëve të përfshirë jo vetëm nga strukturat e policisë, por dhe nga IAL të tjera si dhe nga organe</p>

*Arben Basha*

*[Signature]* 24



mjekësisë) dhe institucione publike e private.	ligjzbatuese. Kjo është qasja e duhur dhe GVJ e inkurajon atë (Evidenca 8, f. 8-10; Evidenca 5; Evidenca 6; Evidenca 14; Evidenca 14.1).			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësitë që ofrojnë këtë program studimi ka të rregulluar veprimtarinë e bashkëpunimit dhe marrjes së mendimeve nga strukturat e policisë së shtetit ku do të shërbejnë pas diplomimit studentët e programit dhe i reflekton këto mendime në përmbajtjen e programit.</li> <li>- Njësitë përgjegjëse, për përmirësimin e programit të studimit, bashkëpunon me IAL të tjera si dhe me misione të huaja të bashkëpunimit policor, organizata ndërkombëtare si dhe organe ligjzbatuese shqiptare.</li> <li>- Në drejtim të përmirësimit të elementeve të programit të studimit, njësitë përgjegjëse zhvillojnë dhe kanë të dokumentuar procesin e marrjes së mendimeve të studentëve dhe alumni-t, sidomos edhe për të vlerësuar cilësinë e formimit që ata kanë përfituar, parë në raport me strukturat policore ku janë punësuar pas diplomimit.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]* 25


### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi, objekt vlerësimi, ofron mësimdhënie në forma të ndryshme, duke përfshirë leksione, seminare, punime apo detyra kursi, stërvitjet e grupuara, praktikat profesionale, projektet, vizitat mësimore si dhe forma apo aplikacione të tjera të reja, të përdorura nga homologët apo IAL të tjera. Ndarja e orëve mësimore është balancuar drejt midis orëve për transmetim dijesh dhe orëve për lexim, hulumtim, dhe përgatitjet individuale të studentëve. Gjithashtu, stafi akademik organizon leksione të hapura si dhe veprimtari me studiues dhe profesionistë të jashtëm ( <i>Evidenca 13, neni 8; Evidenca 8; Evidenca 21; Evidenca shtesë 17</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në përgjithësi, format dhe metodat e mësimdhënies janë të larmishme dhe u sigurojnë studentëve mundësitë e duhura për mësimnxënie sipas nevojave të tyre. Kjo gjë u theksua edhe nga studentët, gjatë takimit të zhvilluar me ta, të cilët vlerësuan larminë e qasjeve didaktike të pedagogëve dhe faktin që ato iu përshtaten tipologjive të ndryshme të studentëve. Kjo qasje praktike, duhet pasqyruar në mënyrë më të plotë në syllabus-et e programit, të cilët jo gjithnjë sigurojnë detaje të mjaftueshme mbi përmbajtjen e temave dhe qasjen e mësimdhënies.  ( <i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion – takimi me studentët"</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	AS ka përcaktuar një politikë mbështetëse dhe promovuese ndaj personelit të tij akademik në mënyrë që rrisin aftësitë e tyre profesionale dhe pedagogjike ( <i>Evidenca 1, neni 7; Evidenca 20</i> ).  Institucioni ka gjithashtu mekanizma si dhe ka vënë në jetë programe për të mbështetur kërkesat e stafit akademik për pjesëmarrje në veprimtari të përmirësimit të metodave të mësimdhënies ( <i>Evidenca 18; Evidenca 18.1</i> ). Rezulton po ashtu se Akademia ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi si dhe është mundësuar mobiliteti i personelit ( <i>Evidenca 6; Evidenca "Tabelat përmbledhëse-tabela 20</i> ).

*Asist. Prof. Dr. ...*

*[Signature]*

	<p>Rritja e mobilitetit të stafit akademik, vlerësohet se do të ndihmonte në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojë në transferimin e njohurive e koncepteve të lëndëve që mbulojnë (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse – tabelat 6, 7, 8)</i>.</p> <p>Po ashtu, metodat e përdorura në mësimdhënie vlerësohen nga studentët si në pyetësorë ashtu edhe në takimin me GVJ. Kjo është një pikë e fortë e programit, e cila duhet përmirësuar më tej. Gjithashtu, GVJ vëren se përdoren metoda alternativa të mësimdhënies si dhe studentët nxiten që të japin mendimin e tyre kritik për çështje të caktuara që diskutohen, raste praktike të ndryshme. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda bashkëkohore dhe ambientet janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e mësimin, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve (<i>Evidenca 28; Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takimi me studentët"</i>).</p> <p>Stafi akademik i angazhuar më këtë program studimi përdor forma mësimdhënieje që inkurajojnë autonominë tek studentit. Sipas përgjigjeve të studentëve gjatë vizitës së GVJ-së rezulton se ata kanë ndërtuar një marrëdhënie respekti të ndërsjellë me pedagogët. Studentët dhe pedagogët shkëmbejnë mendime dhe argumente lidhur me çështjet që shtrohen për zgjidhje. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale (<i>Evidenca 2, neni 89</i>). Institucioni ka miratuar për këtë qëllim standardet dhe normat e sjelljes, të përfshira në Rregulloren e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, të cilat ndihmojnë garantimin e sa thënë më lart (<i>Evidenca 3.1, krerët VI-VII</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit së AS, është njësia përgjegjëse që ofron programin e studimit Bachelor në "Siguria dhe Hetimi". Studentët e regjistruar në këtë program studimi kryejnë vlerësimin e formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në këtë aspekt, studentët vlerësojnë pedagogët në mënyrë anonime si edhe nëpërmjet fokus-grupeve me studentë për marrjen e mendimit të tyre, ku këto vlerësime mbeten një nga elementët kryesorë për arritjen e cilësisë akademike (<i>Evidenca 57; Evidenca shtesë 13</i>).</p> <p>Këto mënyra vlerësimi u evidentuan edhe gjatë vizitës dhe janë pasqyruar dhe pasqyrohen edhe në raportet që lidhen me vlerësimet e studentëve (<i>Evidenca 62.2; Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takimi me studentët"</i>).</p>




27

	<p>Në vijim, personeli akademik i angazhuar në këtë program, kryen vlerësimet e tij lidhur me procesin e mësimdhënies, gjë që në tërësi i vlen përmirësimin të formave dhe metodave të përdorura gjatë këtij procesi (<i>Evidenca 8</i>).</p> <p>Rezultoni se njësia përgjegjëse që mbulon këtë program studimi ka ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të përmirësimin të disa elementeve të programit, pasqyruar në analizën e përgatitur për këtë qëllim (<i>Evidenca 14; Evidenca 14.1; Evidenca shtesë 10</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në AS ka për qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe në bazë të përcaktimeve statutoje janë krijuar strukturat përgjegjëse që drejtohen në nivel institucional nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë. Po ashtu, në nivel institucioni është ngritur Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si njësi e pavarur që ka për qëllim monitorimin, vlerësimin dhe zhvillimin e përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së këtij institucioni. Kjo njësi i kryen vlerësimet në fjalë në mënyrë periodike (<i>Evidenca 1, nenet 16 dhe 61</i>).</p> <p>NJSBC orienton dhe këshillon njësitë bazë për hartimin, riorganizimin dhe përmirësimin e kurrikulave si dhe formulon rekomandime dhe sugjerimeve për mënyrën e organizimit të procesit mësimor, që të ruhen dhe garantohen standardet e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 60, neni 18</i>).</p> <p>AS, nëpërmjet strukturave të saj, shfaq vullnet në drejtim të përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies (<i>Evidenca 2</i>). Gjithashtu, konstatohet se personeli akademik ka marrë trajnim për përmirësimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies (<i>Evidenca 17; Evidenca 18; Evidenca 18.1; Evidenca shtesë 16.4</i>).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Në këtë program studimi mësimdhënia realizohet me larmi formash, ku përfshihen leksione, seminare, punime apo detyra kursi, stërvitjet e grupuara, praktikat profesionale, projektet, vizitat mësimore si dhe forma apo aplikacione të tjera të reja. Stafit akademik organizon leksione të hapura si dhe veprimtari me studiues dhe profesionistë të jashtëm. Kjo qasje praktike, duhet pasqyruar në mënyrë më të plotë</i></li> </ul>

*Handwritten signature in blue ink.*

	<p><i>në syllabus-et e programit, të cilët jo gjithnjë sigurojnë detaje të mjaftueshme mbi përmbajtjen e temave dhe qasjen e mësimdhënies.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni ka mekanizma si dhe ka vënë në jetë programe për të mbështetur kërkesat e stafit akademik për pjesëmarrje në veprimtari të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda bashkëkohore dhe ambientet janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e mësimit, diskutimeve apo dhe për detyra praktike.</i></li> <li>- <i>Format dhe metodat e mësimdhënies iu nënshtrohen vlerësimit periodik si nga ana e personelit akademik, ashtu dhe nga studentët. Mbi bazën e të dhënave të marra, vijohet me reflektimin e ndryshimeve apo përmirësimeve në lidhje me këto metoda të mësimdhënies.</i></li> <li>- <i>Për të garantuar përmirësimin e metodave të mësimdhënies, IAL garanton bashkëpunimin e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC me njësitë bazë si dhe ka organizuar trajnime për përmirësimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor dhe në syllabusin e secilës lëndë. Shkalla e përvetësimit të dijës nga studentët bëhet sipas sistemit me notë, pikë ose me përqindje dhe me shkronja (sistemi ETCS me shkronjat nga A-F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Studentët njoftohen mbi këtë rregullore gjatë javës së parë të fillimit të studimeve (orientimit), si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse (*Evidenca 13*;

*[Signature]*

*[Signature]* 29

	<p><i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion –takime me stafin akademik dhe studentët").</i></p> <p>Rregullorja dhe afatet e përcaktuara në kalendarin akademik bëhen publike dhe mund të konsultohen <i>online (Evidenca 37; Evidenca 40).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të përmbajtjes së tyre, GVJ konstaton se syllabuset përmbajnë kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive të studentëve. Vlerësimi bëhet përmes metodave të ndryshme dhe është i rregulluar në dokumentet dhe udhëzuesit e programit. Studentët në fillim të çdo semestri njoftohen me format dhe kriteret e vlerësimit. Gjithsesi, ka vend që <b><i>në syllabuse të përfshihen më shumë detaje mbi kriteret e vlerësimit të secilit komponent</i></b>, në veçanti matja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminare, grupet e punës, etj. (<i>Evidenca 13, kreu VI; Evidenca 8, pjesa III).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sipas përcaktimeve të kreu VI të Rregullores së programit të studimit, lëndët e përfshira në këtë program studimi vlerësohen me metoda të vazhdueshme, dinamike e të larmishme, gjë që ofron mundësi për vlerësim të përshtatshëm të dijeve (<i>Evidenca 13</i>). Edhe pse shumica e lëndëve ndjekin vlerësimin e vazhdueshëm të ndarë në disa komponente (si p.sh. pjesëmarrja dhe aktivizimi, provimi i ndërmjetëm dhe provim përfundimtar), sugjerohet që të ketë më shumë larmi të vlerësimit, duke mos aplikuar të njëjtat forma vlerësimi për çdo lëndë. Pra, duhet bërë një vlerësim dhe ndarje duke pasur parasysh se disa lëndë mund të vlerësohen më drejt nëpërmjet eseve, kurse të tjera nëpërmjet provimeve dhe projekteve grupore, me synimin që në fund, studentët të pajisen me aftësi të ndryshme akademike e profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Forma kryesore e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik realizohet përmes pyetësorëve të studentëve që mbahet në fund të çdo semestri. Rezultatet e përmbledhura të këtyre vlerësimeve u bëhen me dije nga ana e NJSBC-së stafit akademik dhe organeve përkatëse drejtuese me synim marrjen e masave plotësuese për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në të ardhmen (<i>Evidenca 60, neni 31; Evidenca 62.3; Evidenca 62.4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të</p>	<p>AS dhe fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, ku është i vendosur programi, ofrojnë kohë pas kohë kurse, trajnime dhe pjesëmarrje në aktivitete për zhvillim profesional dhe didaktik</p>

<p>shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>të stafit akademik. Akademia ka mekanizma (kryesisht të centralizuar) për të mbështetur kërkesat e stafit akademik për pjesëmarrje në programe të përmirësimit të metodave të mësimdhënies (<i>Evidenca 17; Evidenca 18; Evidenca 18.1; Evidenca 21; Evidenca shtesë 16.4</i>).</p> <p>Lëndët e mbuluar nga ky program në përgjithësi ofrojnë qasje të balancuar të mësimdhënies, ku provimet dhe esetë synojnë të zhvillojnë shkathësitë autonome të mendimit kritik dhe kërkimit, ndërsa pjesëmarrja në klasë si dhe puna në grup synon të zhvillojë shkathësi të ndërveprimit në grup dhe shoqëri (<i>Evidenca 8, pjesa III</i>). Ky kombimin metodash konsiderohet si i përshtatshëm dhe është i mirëpritur nga studentët (<i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion - takim me studentët"</i>).</p>
--	--

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje që ka evidentuar në pjesën përshkrimore, në mënyrë që ta ketë më të thjeshtë për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor dhe në syllabusin e secilës lëndë, për të cilat studentët marrin dijeni gjatë javës së parë të fillimit të studimeve (orientimit), si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse.</i></li> <li>- <i>Studentët njoftohen në fillim të çdo semestri me format dhe kriteret e vlerësimit. Ka vend që në syllabuse të përfshihen më shumë detaje mbi kriteret e vlerësimit të secilit komponent.</i></li> <li>- <i>Rregullorja e programit përcakton metoda të vazhdueshme, dinamike e të larmishme për testimin dhe vlerësimin e dijeve. Sugjerohet që të ketë më shumë larmi të vlerësimit, duke mos aplikuar të njëjtat forma vlerësimi për çdo lëndë.</i></li> </ul>
---------------------------	--

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X


**Standardi III.3**

*Arbes Mues*

*JA* 31

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentëve realizohet përmes komponentëve të vazhdueshëm që reflektohet në vlerësimin përfundimtar të secilit student për lëndën përkatëse. Kriteret, përqindjet, si dhe sistemi i vlerësimit është i rregulluar dhe paraqitur në përmbajtjen e çdo syllabusi. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit akademik, elementet e përcaktuar në syllabusin e lëndës, përbëjnë 40% të vlerësimit të studentit, kurse vlerësimi përfundimtar përbën 60% të vlerësimit të studentit, raporte këto të përcaktuar në rregulloren e AS si dhe në atë të programit të studimit (<i>Evidenca 3, neni 65; Evidenca 13, neni 33; Evidenca 8, pjesa III</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita e kryer në institucion rezultoi se nuk ka një system elektronik të testimit dhe vlerësimit të provimeve (<i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takim me stafin akademik dhe GVB"</i>).</p> <p>Rregullat për zhvillimin e provimeve janë të përcaktuara në rregulloren e programit, ku përcaktohet se provimi i çdo lënde zhvillohet me shkrim, nën mbikëqyrjen e një komisioni pedagogësh, si rregull titullari dhe asistenti i tij. Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara dhe institucioni siguron mjetet e nevojshme për monitorimin e procesit (<i>Evidenca 13, kreu VI</i>). Gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, në institucion është përdorur platforma elektronike <i>Google classroom</i> (<i>Evidenca 29; Evidenca 29.2; Evidenca 29.3; Evidenca 29.4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me rregullimet e nenit 71 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në syllabusin e secilës lëndë (<i>Evidenca 13, neni 31; Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takim me stafin akademik"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me</p>	<p>Në varësi të formatit të vlerësimit, studentët përveç notës mund të marrin edhe komente me qëllim arsyetimin e vlerësimit si dhe sugjerime për përmirësim në të ardhmen. Ky kriter përfshihet ndër të drejtat e studentëve gjatë kohës që</p>



 32



<p>komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>frekuentojnë këtë program studimi (<i>Evidenca 13, neni 39</i>). Studentët kanë të drejtë të kërkojnë një sesion konsultimi me pedagogun pas provimit për të sqaruar notën apo bërë ndonjë ankesë, ku u jepet mundësia për t'u ballafaquar me vlerësimin e kryer (<i>Evidenca 3.1, neni 95; Evidenca shitesë "Shënime në institucion-takim me stafin akademik"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>AS dhe fakulteti përgjegjës për programin kanë rregulla normative sa i përket integritetit akademik, përfshirë këtu edhe plagjiaturën, duke bërë parashikime konkrete për shmangien e saj në aktet e brendshme të institucionit. Studentët marrin dijeni për këtë detyrim nëpërmjet rregullores së fakultetit (<i>Evidenca 3.1, neni 112</i>).</p> <p>Por, pavarësisht parashikimeve në aktet e brendshme rregullatore, nga vizita në institucion, gjatë takimit me pedagogët, <i>u konstatua se nga institucioni dhe njësia përgjegjëse për këtë program, nuk ka në përdorim një platformë të mirëfilltë antiplagjiaturë në përdorim e sipër</i> (<i>Evidenca shitesë "Shënime në institucion-takim me stafin akademik dhe GVB"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Për këtë program studimi, ndiqen rregullat e përgjithshme të AS mbi vlerësimin e studentëve. Sipas <i>nenit 68</i> të Rregullores institucionale, provimet përfundimtare me shkrim bëhen të sekretuara. Sekretimi realizohet nga sekretaria. Provimet e sekretuara hapen pas vlerësimit të tyre nga pedagogu në një seancë të parashikuar për dhënien e rezultateve. Seanca në fjalë parashikohet dhe iu njoftohet studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë kalendarike. Këto rregullime shprehen edhe në Rregulloren e programit të studimit, e cila cakton një afat prej 3 ditë për njoftimin e rezultateve të provimeve. Vlerësimi përfshin të gjithë komponentët e përmendur në syllabusin e lëndës, sipas mënyrës së aktivizimit të studentit përgjatë periudhës së vitit akademik (<i>Evidenca 3; Evidenca 13, nenet 31-33; Evidenca 8, pjesa III</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,</p>	<p>Programi iu mundëson studentëve të ankohen në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre gjatë procesit të vlerësimit. Studenti ka të drejtë të ankohet si për procesin e zhvillimit të provimit, ashtu dhe për vlerësimin e kryer. Kështu, sipas <i>nenit 69</i> të Rregullores akademike (institucionale), studentit ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa me shkrim i paraqitet përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga dita e</p>

*Arled Mustafa*

*JH* 33

<p>rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>zhvillimit të provimit. Sipas <i>nenit 70</i> të së njëjtës rregullore, ankimi mbi vlerësimin i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit (<i>Evidenca 3</i>). Kurse, në rregulloren e programit, parashikohet (me të drejtë) afati prej 48 orë nga marrja dijani e rezultatit të provimit për paraqitjen e ankimit para përgjegjësit të departamentit për vlerësimin e provimit (<i>Evidenca 13, neni 34</i>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në vijim të përcaktimeve të bëra në Rregulloren akademike dhe atë të programit, përgjegjësi kryen verifikimet e duhura dhe kur nuk mund ta zgjidhë ankesën, njofton dekanin. Dekani, brenda 48 orëve nga njoftimi i bërë prej përgjegjësit të departamentit, ngre një komision <i>ad hoc</i>, i cili kryen verifikimin e pretendimeve të studentit. Komisioni, me miratimin e dekanit, përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit (<i>Evidenca 3, neni 70; Evidenca 13, neni 34</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua se raste të paqartësisë për vlerësimin janë zgjidhur gjatë konsultimit të bërë me pedagogët e lëndës dhe nuk ka asnjë rast që ankimi të ketë ndjekur rrugët e përcaktuara në <i>nenin 70</i> të Rregullores institucionale. Në këto kushte, nuk ka praktika të arkivuara për këtë qëllim (<i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takim me stafin akademik dhe me studentët"</i>).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ</i> për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentëve realizohet përmes komponentëve të vazhdueshëm që reflektohet në vlerësimin përfundimtar të secilit student për lëndën përkatëse. Kriteret, përqindjet, si dhe sistemi i vlerësimit është i rregulluar dhe paraqitur në përmbajtjen e çdo syllabusi si dhe bazohet në përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi.</li> <li>- Për të kryer vlerësimin, AS dëshmon se është në gjendje të përdorë dhe platforma elektronike.</li> <li>- Vlerësimet jepen në përputhje me meritat e secilit student, sipas përcaktimeve në syllabus, iu komunikohen atyre në afatet e parashikuara si dhe mund të shoqërohen me sugjerime që ndihmojnë studentin për t'u përmirësuar.</li> <li>- AS ka bërë parashikimet e duhura në aktet e brendshme rregullatore për të shmangur dhe parandaluar plagjiaturën, por nuk ka një sistem të ngritur për këtë qëllim. <i>GVJ</i> sugjeron marrjen e masave konkrete për ngritjen e një sistemi antiplagjiaturë.</li> </ul>

*[Signature]*

*[Signature]* 34


	- Vlerësimi me notë mund të ankimohet nga studenti sipas procedurave të detajuara në Rregulloren akademike të institucionit dhe në Rregulloren e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi ka strukturë të përshtatshme për t'iu siguruar studentëve njohuri teorike, analitike dhe praktike mbi fushën e studimit të rendit dhe sigurisë publike. Lëndët bazë dhe ato mbështetëse kryesisht mbulojnë aspektet teorike, historike, metodologjike si dhe praktike të fushave në fjalë. Programi ofron mundësi praktike profesionale dhe mobiliteti dhe shfrytëzon bashkëpunimet ndërkombëtare për t'i shkathtësuar studentët edhe në aspektin profesional ( <i>Evidenca 13; Evidenca 8, pjesa III</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi garanton zhvillimin e një sërë aftësive në fushat kërkimore, analitike dhe profesionale përmes leksioneve, punës në grup të studentëve dhe programeve shkëmbyese të mobilitetit, gjë e cila u konfirmua edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët ( <i>Evidenca 13; Evidenca 8; Evidenca 15; Evidenca 7; Evidenca shtesë 17; Evidenca shtesë "Shënime në institucion"</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e	Studentët informohen nga pedagogu i secilës lëndë lidhur me kompetencat dhe aftësitë që secila lëndë synon të krijojë tek ta, sipas programeve përkatës. Rregullorja e programit i udhëzon pedagogët të zhvillojnë lëndët përmes metodave dhe përmbajtjes, të cilat iu mundësojnë studentëve nxënien e dijes dhe fitimin e aftësive të përcaktuara për programin në fjalë. Në fund të çdo semestri, pedagogët dhe studentët diskutojnë dhe vlerësojnë përmbushjen e objektivave të secilës lëndë ( <i>Evidenca 8, pjesa III; Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takim me stafin akademik dhe studentët"</i> ).  Lëndët bazë dhe ato mbështetëse të programit kanë të parashikuar sesione në fund të çdo semestri për të diskutuar mbi

<p>tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>formatin e provimeve si dhe mbarëvajtjen e tyre. Gjithashtu, pedagogët janë në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit, sa herë që rezulton e nevojshme (<i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion"</i>).</p> <p>Përgjatë periudhës së pandemisë, evidentohet se janë zhvilluar orë konsultuese për të diskutuar çështje të ndryshme të vëna në dukje nga studentët si dhe njohuritë e fituara prej tyre gjatë semestrit (<i>Evidenca 29.3</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuar në një mënyrë të tillë që tregojnë se përmbajtja e leksioneve si dhe format e vlerësimit janë ndërthurur për t'iu ofruar studentëve mundësinë e zhvillimit të aftësive teorike, analitike dhe profesionale për lëndët përkatëse. Praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm në këtë program studimi (<i>Evidenca 8; Evidenca 7; Evidenca 7.1; </i>).</p> <p>Personeli akademik nxit punën në grup nëpërmjet hulumtimit të rasteve dhe ofron udhëzime për planifikimin, shkrimin dhe prezantimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. Po ashtu, syllabuset e lëndëve kanë pjesëmarrjen si komponent të vlerësimit të vazhdueshëm. Nga ana tjetër, nuk ofrojnë detaje të mjaftueshme mbi teknikat dhe metodat e punës në grup. <b><i>Syllabuset duhet të ofrojnë më shumë udhëzime mbi aktivitetet e punës në grup dhe kriteret e vlerësimit të pjesëmarrjes aktive</i></b> (<i>Evidenca 8, pjesa III; Evidenca shtesë "Shënime në institucion"</i>).</p> <p>Pjesëmarrja aktive në diskutimet gjatë leksioneve është hapësira kryesore ku studentëve iu jepet mundësia për shprehje dhe zhvillim të ideve inovative. Format e tjera të vlerësimit, po ashtu, ofrojnë hapësirë për të paraqitur ide teorike dhe praktike për fushën e lëndës (<i>Evidenca 8, pjesa III</i>).</p> <p>Studentët e këtij programi përfitojnë nga mundësia për të aplikuar për shkëmbim akademik dhe mobilitet falë marrëveshjeve bashkëpunuese që AS ka nënshkruar me universitete të huaja në fushën policore dhe organizma të tjerë të ngjashëm. Personeli akademik si dhe Zyrat në shërbim të studentëve iu ofrojnë këtyre të fundit udhëzime e asistencë për aplikim për mobilitet (<i>Evidenca 13; Evidenca 6; Evidenca shtesë 4; Evidenca shtesë 16.1</i>)</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion, studentët sugjeruan që të ketë rritje të numrit të mobilitetit të tyre si dhe në program t'u jepet hapësirë shkencave të komunikimit, duke pasur parasysh punën</i></p>





	<i>e tyre të mëtejshme në shërbim të policisë së shtetit (Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takimi me studentët").</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Programi iu ofron studentëve qasje në veprimtari ekstra-kurrikulare, përfshirë këtu ndjekjen e leksioneve të hapura nga akademikë të huaj, konferenca shkencore si dhe ngjarje të tjera për promovim dhe ngritje të rrjeteve profesionale ( <i>Evidenca 8; Evidenca 48; Evidenca shtesë 17</i> ).			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Programi ka strukturë të përshtatshme për t'iu siguruar studentëve njohuri teorike, analitike dhe praktike në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.</i></li> <li>- <i>Në fund të çdo semestri, pedagogët dhe studentët diskutojnë dhe vlerësojnë përmbushjen e objektivave të secilës lëndë, gjë që realizohet gjithashtu gjatë gjithë vitit akademik. Këto vlerësime dhe diskutime janë kryer edhe gjatë periudhës së pandemisë.</i></li> <li>- <i>Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuar në një mënyrë të tillë që tregojnë se përmbajtja e leksioneve si dhe format e vlerësimit janë ndërthurur për t'iu ofruar studentëve mundësinë e zhvillimit të aftësive teorike, analitike dhe profesionale për lëndët përkatëse. Syllabuset duhet të ofrojnë më shumë udhëzime mbi aktivitetet e punës në grup dhe kriteret e vlerësimit të pjesëmarrjes aktive.</i></li> <li>- <i>Universiteti siguron pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme për studentët, garanton kërkimin shkencor, mobilitetin, nëpërmjet marrëveshjeve dhe strukturave të ngritura për këtë qëllim</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	


### Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



 37

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit konsiderohet i përfunduar vetëm kur studentët japin me sukses provimin e diplomës. AS, ku është i vendosur programi në fjalë, ka udhëzime të detajuara për procedurat e zhvillimit të provimit përfundimtar si dhe për përgatitjen e mbrojtjes së provës finale për diplomimin e studentëve, të cilat janë parashikuar në Rregulloren e fakultetit si dhe atë të programit të studimit. Në përputhje me delegimet e Rregullores së programit të studimit, Akademia ka detajuar në mënyrë të hollësishme procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, monitorimit, prezantimit dhe të vlerësimit të temës së diplomës, ku parashikohen po ashtu të drejtat dhe detyrat e personave të përfshirë në këtë proces (<i>Evidenca 3.1, kreu III; Evidenca 13, kreu VIII</i>).</p> <p>Procedurat për mbrojtjen e diplomës janë publike dhe iu komunikohen studentëve nga ana e pedagogëve dhe strukturave të tjera të universitetit, konfirmuar gjatë takimeve me stafin dhe studentët (<i>Evidenca 37; Evidenca shtesë "Shënime në institucion"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Procedurat për zhvillimin, shkrimin, dhe mbrojtjen e tezës së diplomës ose shlyerjen e provimit të diplomimit, iu bëhen të ditura studentëve përgjatë ciklit akademik. Studenti udhëhiqet nga një pedagog me përvojë në fushën e temës së përzgjedhur. Studentët asistohen përmes takimeve dhe komunikimeve me pedagogët udhëheqës (<i>Evidenca 13, kreu VIII</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në përputhje me <i>nenin 73</i> të Rregullores akademike, për përmbylljen e studimeve me temë, departamenti propozon një komision, i cili përbëhet nga 3 deri 5 anëtarë, të propozuar nga departamentet përkatës. Komisioni miratohet nga dekani i fakultetit nëpërmjet një vendimi ku përcaktohen data dhe ora e provimit. Ky vendim i komunikohet edhe sekretarisë, me qëllim që të marrë masat për të përgatitur fletët e vlerësimit (<i>Evidenca 3, kreu III; Evidenca 13, kreu VIII</i>).</p> <p>Për të kryer vlerësimin, komisioni ndjek një sërë kriteresh, që shprehen në pikët përkatëse, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e programit (<i>Evidenca 13, kreu VIII</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</p>	<p>Institucioni ka të rregulluar në aktet e brendshme procedurën e përcaktimit të temave të diplomave dhe hapat e ndjekur në vijim, ku personeli akademik është i angazhuar dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së diplomës. GVJ konstaton se përdoret një qasje e kombinuar ku pedagogët përkatës si dhe studentët bashkëpunojnë për përzgjedhjen e temave të</p>

*Arvel Mustafaj*

*JAB* 38

<p>Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>diplomës në të cilat ata kanë interes, ekspertizë, dhe janë në gjendje të udhëheqin dhe ta mbyllin me sukses këtë proces. Drejtuesit e temave miratohen nga departamenti. Pedagogët udhëheqës të temave të diplomave asistojnë studentët përgjatë gjithë procesit të përpilimit, hulumtimit dhe shkrimit të temës. Ata përkujdesen që studentët të respektojnë standardet dhe procedurat e temës. Temat që nuk respektojnë formatin, rregullat si dhe etikën dhe integritetin akademik (përfshirë plagjiaturën) nuk pranohen dhe nuk procedohen për mbrojtje publike (<i>Evidenca 3.1, neni 106 në lidhje me nenin 112</i>).</p> <p>Nga <i>RVB, f. 16</i>, si dhe gjatë vizitës në institucion, konfirmohet se në përfundim të programit të studimit, objekt vlerësimi, nuk paraqitet punim diplome nga studentët, por kryhet vetëm një provim i përgjithshëm përfundimtar. Personeli akademik i orienton studentët në përgatitjen para provimit përfundimtar me një listë pyetjesh parapërgatitore, duke iu ofruar seanca këshillimi, etj. (<i>Evidenca shtesë "Shënime në institucion-takimi me stafin akademik dhe GVB"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësisia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pavarësisht se në përfundim të këtij programi studimi, nuk paraqitet punim diplome nga studentët, nga aktet e brendshme rezulton se AS dhe fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit u sigurojnë studentëve mbështetje në tri drejtime, gjatë procesit të hulumtimit dhe shkrimit të temës.</p> <p>Së pari, ofron hapësirën kërkimore, nëpërmjet shërbimit të bibliotekës fizike dhe platformave elektronike për të konsultuar tekste, libra, artikuj dhe materiale të tjera të vlefshme për këtë qëllim (<i>Evidenca 34.3; Evidenca 35; Evidenca 36</i>);</p> <p>Së dyti, pedagogu udhëheqës ofron mbështetje akademike dhe metodologjike gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe shkrimit të temës (<i>Evidenca 13, neni 42</i>);</p> <p>Së treti, AS asiston studentët gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave përmes shfrytëzimit të bashkëpunimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit (<i>Evidenca 6; Evidenca 6.1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar për këtë program studimi, studenti vlerësohet me notë sipas kritereve dhe mënyrës së pikëzimit (1-100) të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit (<i>Evidenca 13</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti</p>	<p>Me përfundimin dhe mbrojtjen me sukses të temës së diplomës dhe përmbushjes të të gjithë detyrimeve të tjerë, studentët</p>



<p>pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>pajisen me diplomën përkatëse të shoqëruar me suplementin e saj. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit dhe rektori i AS (<i>Evidenca 3, neni 75; Evidenca 3.1, neni 108; Evidenca 13, nenet 45-46; Evidenca shtesë 3</i>).</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentëve iu vihet në dispozicion tema e diplomës dhe suplementi zyrtar, ky i fundit edhe në gjuhën angleze (<i>Evidenca 8, pjesa III</i>). Kopja e programit të studimit, planit mësimor dhe syllabuseve, iu vihet në dispozicion studentëve të interesuar që kanë paraqitur kërkesë për këtë qëllim (<i>RVB, f. 17</i>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>AS ruan kopje të dokumentacionit të studentëve dhe të procesit mësimor, në përputhje me sistemin e brendshëm arkivor, përfshirë këtu mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat administrohen në sekretarinë e institucionit dhe zyrën e arkivës, veprimtaria e të cilave është rregulluar me akte të brendshme, zyra të cilat mundësojnë dhënien e informacioneve të nevojshme për studentin (<i>Evidenca 3, nenet 62-63; Evidenca 3.1, kreu V; Evidenca 45; Evidenca 46; Evidenca 47</i>).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar udhëzime të detajuara për procedurat e provimit të përgjithshëm përfundimtar/përgatitjes së mbrojtjes së provës finale për diplomimin e studentëve, të cilat janë parashikuar në Rregulloren akademike, Rregulloren e fakultetit si dhe atë të programit të studimit. Këto procedura janë bërë publike si dhe iu komunikohen në kohën e duhur studentëve.</i></p> <p><i>Studenti udhëhiqet nga një pedagog me përvojë në fushën e temës së përzgjedhur. Për përmbylljen e studimeve me temë, departamenti propozon komisionin përkatës, i cili përbëhet nga 3-5 anëtarë.</i></p> <p><i>Personeli akademik është i angazhuar dhe ndihmon studentët për t'u përgatitur për provimin e përgjithshëm përfundimtar nëpërmjet pyetjeve orientuese, këshillimeve, etj.</i></p> <p><i>Provimi i përgjithshëm përfundimtar vlerësohet me notë, sipas kritereve të përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit.</i></p> <p><i>Procesi përmbyllet me pajisjen me diplomë të studentit, sipas formatit të miratuar dhe me suplementin përkatës. Dokumentacioni mësimor dhe ai që lidhet me studentët, ruhet nga institucioni nëpërmjet strukturave të ngritura për këtë qëllim.</i></p>

*Arif Ahmeti*

*[Signature]* 40



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit BA në “Hetim dhe Siguri” reflekton një ndërthurje të përvojës së nevojshme profesionale dhe akademike për të zhvilluar një proces akademik në përputhje me natyrën e programit. Ndërthurja e përvojës akademike dhe profesionale të stafit përputhet me qëllimin dhe objektivat e programit si një program në shërbim të institucionit të Policisë së Shtetit dhe organeve të tjera ligjzatuese.</p> <p>Ky tipar i referohet stausit të veçantë që gëzon Akademia e Sigurisë dhe nevojës për mbulimin e lëndëve apo moduleve të natyrës praktike. Përvoja profesionale e stafit akademik inkurajon përvetësimin e lëndëve të natyrës praktike të cilat janë pjesë e kurikulës mësimore të këtij programi. Për kategorinë e stafit që vjen nga karriera policore ekuivalentimi i gradave policore në tituj dhe grada akademike bëhet në përputhje me kriteret e VKM nr. VKM nr. 881 datë 28.10.2020 “Për dhënien e stausit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”. Stafi akademik, veçanërisht PAE me status civil ka progresuar në drejtim të procesit të kualifikimit akademik, por ka process ka ende nevojë të vijojë me hapa të përshpejtuar.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë</p>




dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit, bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 të RVB është:

1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 39 pedagogë nga të cilët 24 PAE dhe 15 PAK (62 % /38 %)
2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 30 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 9 PAK (70 % /30 %)
3. Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 31 pedagogë nga të cilët 23 PAE dhe 8 PAK (75 % / 25 %):


Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022- 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	4	2	4	1	4	1
Prof.As.Dr	3	2	5	1	6	1
Dr/PhD	12	3	7	1	9	1
Msc	5	8	5	6	4	5
Në total	<b>24</b>	<b>15</b>	<b>21</b>	<b>9</b>	<b>23</b>	<b>8</b>

*Evidenca RVB (Ankes tabelat 6.1-6.3)*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Struktura organizative e Fakultetit të Sigurisë së Hetimit ka në përbërje numrin e nevojshëm të stafit akademik për të mundur këtë program studimit. Stafi akademik i kësaj njësie përbëhet si nga personel akademik afektiv, ashtu edhe personal akademik me kontratë. AS-ja si njësi kryesore nxit kualifikimin profesional të personelit akademik dhe integrimin e veprimtarisë kërkimore me atë të mësimdhënies në përputhje me natyrën dhe objektivat specifike të institucionit. Për këtë qëllim janë ngritur struktura të dedikuara për zhvillimin e veprimtarisë së kërkimeve shkencore si Qendra e Kërkimeve Shkencore Ndërdisciplinore. Kjo qendër boton revistën "Policimi dhe Siguria", si botim periodiko-shkencor për njohjen dhe publikimin e veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore të AS-së, në përmbushje të standardeve dhe kërkesave të kohës.

Ndërkohë pasi analizuam informacionin e dhënë në tabelat 12.1-12.3 të RVB, për ngarkesën e personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:




	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 2020-2021 80% / 20%;</li> <li>• 2021-2022 83 % / 17%</li> <li>• 2022-2023 88 % / 12 %</li> </ul> <p><i>Evidenca RVB (Aneks tabelat 12.1-12.3)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik realizohet duke respektuar aktet ligjore në fuqi si dhe kriteret që i referohen kategorive të personelit civil apo policor. Pranë Akademisë së Sigurisë për realizimin e programit të studimit janë angazhuar përveç personelit akademik efektiv, edhe personal akademik me kontratë. Në të dy rastet, Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet personale për të gjithë personelin akademik si dhe atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ, si dhe bën përditësimin e vazhdueshëm të tyre.</p> <p>Dosja e personelit akademik përmban edhe të dhëna lidhur me eksperiencën profesionale dhe kualifikimin shkencor si dhe kontratën e punës. Institucioni respekton detyrimet ligjore që lidhen me mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Qëndrueshmëria e personelit akademik, si atij që vjen nga karriera policore, ashtu edhe për atë civil është një nga faktorët e ritjes së kualifikimit të personelit edhe nëpërmjet përvojës së mësimdhënies. Me qëllim garantimit të qëndrueshmërisë, duhet të minimizohen lëvizjet e personelit që vjen nga karriera policore. <i>Evidenca RVB, Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së stafit akademik reflektojnë natyrën e veçantë të këtij program studimi si dhe nevojën për përmbushjen e objektivave të programit. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit BA në “Hetimi dhe Siguria” ka në përbërje personal me status policor, si dhe personel me status civil. Personeli me status civil, punësohet në AS sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren e AS-së” Pjesa e personelit akademik me gradë policore që mbulon këtë program, vjen nëpërmjet emërimit nga Institucioni i Policisë së Shtetit. Për sa i takon personelit akademik, Institucioni ka ndjekur procedura të rekrutimit të personelit në përputhje me kërkesat e ligjislacionit në fuqi si dhe kriterëve të parashikuara në aktet regullatore të brendshme. Aktet regullatore të institucionit kanë parashikuar procedura të detajuara për përzgjedhjen e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në përputhje me specifikat e programit.</p> <p>Parashikohet edhe përfshirja e Departamenteve, të cilat mund të propozojnë kriteret të veçanta për kandidatët për personel</p>

	<p>akademik. Statuti dhe akte të tjera rregullatore kanë përcaktura kritere të rekrutimit jo vetëm për personelin akademik me kohë të plotë, por edhe për atë më kohë të pjesshme i cili gjithashtu i nështrohet procesit të konkurrimit nëpërmjet dosjes. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik ndiqen në mënyrë rigorozë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentet. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik bëhen publike në përputhje me kërkesat e ligjislacionit në fuqi si dhe akteve rregullatore të institucionit. Përzgjedhja bëhet me konkurim nëpërmjet dosjes, duke konsideruar kriteret e parashikura në rregulloret e brendshme lidhur me kualifikimin profesional si dhe përputhjen e kompetencave me natyrën e programit dhe përmbajtjes së lëndëve. Procedura e rekrutimit fillon me shpalljen e vendeve vakante ku përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike. Më tej vijohet me përzgjedhjen e dosjeve dhe intervistimin e kandidatëve. Edhe përzgjedhja e personelit akademik me kontratë bëhet me konkurim nëpërmjet vlerësimit të dosjes.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 3, Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Personeli i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, si njësi përgjegjëse për realizimin e këtij program studimi, përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ. Detyrat dhe të drejtat e tyre përcaktohen në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, në legjislacionin për Policinë e Shtetit, në Statutin e Akademisë së Sigurisë dhe në rregulloret e brendshme.</p> <p>Procedurat dhe kriteret e rekrutimit që parashikohen në mënyrë të detajuar në aktet rregullatore të institucionit, kanë parashikime që i referohen jo vetëm rekrutimit të stafit akademik, por edhe atij ndihmës akademik dhe administrativ. Personeli ndihmës akademik, ndahet në, personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe kërkimor - shkencor, si dhe personel ndihmës akademik me karakter administrativ. Kjo ndarje është në funksion të përcaktimit dhe detajimit të kompetencave për secilën kategori. Nga vizita në institucion rezultoi se personeli ndihmes akademik ka një angazhim maksimal në funksion të mirëmbajtjes së mjediseve shkollore, si dhe mjediseve të zhvillimit të veprimtarive praktike si Poligani i Qitjes, Palestra etj. Departamentet, si njësitë bazë, mbajnë në vijimësi kontakte të ngushta me strukturat ndihmës akademike dhe administrative përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 3.1</i></p>

*Asst. Prof. Dr. ...*

*[Signature]* 44

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit si njësi kryesore disponon të gjithë informacionin e nevojshëm, mbi funksionimin dhe organizimin e strukturave akademike dhe administrative. Zyra e personelit mbledh, ruan dhe administron bazën e të dhënave të raporteve të rekrutimit të personelit si dhe ecurisë profesionale.</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program si dhe të personelit ndihmës dhe administrativ. Gjithashtu administron një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program në të gjithë vitet akademike si dhe të personave përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Nga vizita në institucion u konstua një angazhim i përshtatshëm i burimeve njëzëzore për zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><i>Evidenca RVG, (Aneks tabelat 1-12)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni me qëllim realizmin e programit ka lidhur një sërë marrëveshjesh me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, apo institucione homologe të cilat i shërbejnë në tërësi procesit akademik të këtij programi studimi. Këto marrëveshje i shërbejnë përshtatjes dhe përmirësimit të kurikulave, pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta si dhe trajnimeve të stafit. Në funksion të nevojave për rritjen e kualifikimit shkencor, institucioni ka lidhur edhe marrëveshje binjakëzimi me institucione analoge në Finlandë, Estoni etj të cilat kanë në fokus trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit. Disa nga këto marrëveshje janë finalizuar nga BE. Stafit është trajnuar nga organizata ndërkombëtare në fushën e policimit dhe sigurisë si PAMECA, FRONTEX etj.</p> <p>Për sa i takon praktikën profesionale, ajo është pjesë e programit mësimor Bachelor në Siguri dhe Hetim. Përmeshja e praktikës profesionale është e detyrueshme për studentët dhe për kryerjen e saj hartohet një program i veçantë. Me fillimin e vitit të fundit akademik, studentët njihen me programin e praktikës dhe kohën e kryerjes së saj. Studentët drejtohen dhe orientohen nga stafi akademik përgjegjës për praktikën. Praktikën zhvillohen në strukturat vendore të policisë, në komisaritet dhe sektorët e drejtorive vendore, nën drejtimin e pedagogut përgjegjës. Praktika profesionale vlerësohet me</p>

*Handwritten signature*

	<p>notë. Në aktet e posaçme regullatore ka përcaktime të qarta në lidhje me kohëzgjatjen, institucionin pritës, modalitetet e zhvillimit, si dhe personin përgjegjës për mbikqyrjen e praktikës.</p> <p><i>Evidenca 6.1, Evidenca 7, Evidenca 7.1, Evidenca 18. Evidenca 18.1; Evidenca 19</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në funksion të realizimit të praktikës profesionale është mundësuar një sistem i qëndrueshëm bashkëpunimi midis AS dhe strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, edhe për faktin se një pjesë e konsiderueshme e pedagogëve vijnë direkt nga praktika.</p> <p>Për të mundësuar zhvillimin e praktikës profesionale në kushte optimale, mbikqyrja e praktikës realizohet edhe nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Zhvillimi i praktikës profesionale pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit lehtëson procesin e administrimit të praktikës si dhe i shërben rritjes profesionale të studentëve në përputhje me objektivat e programit. Synimi kryesor i këtij programi, është vënia në rol e studentëve në të gjitha shërbimet që kryejnë strukturat policore vendore, dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, me qëllim aftësimin e tyre në veprimtarinë praktike, për kryerjen e detyrave sipas rolit që do të kryejnë. Me fillimin e vitit të fundit akademik, departamentet ju bëjnë me dije studentëve programin e praktikës, drejtuesit e grupeve të përzgjedhur nga stafi mësimdhënës për drejtimin e praktikës, vendet e planifikuara për zhvillimin e saj, si dhe kohën e kryerjes së tij.</p> <p><i>Evidenca 7, Evidenca 7.1, Evidenca 8</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë transparente në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi si dhe në aktet e posaçme rregullatore si dhe nevojat për rekrutimin e personali akademik civil dhe atij policor në përputhje me natyrën e veçantë të këtij program studimit.</i></p> <p><i>-Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi përfshirë edhe instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</i></p> <p><i>-Informacioni mbi funksionimin dhe organizimin e strukturave akademike dhe ndihmës akademike administrohet në përputhje me kriteret ligjore dhe përditsohet në mënyrë të vazhdueshme.</i></p>

*Bekir Burticaj*

*JH* 46

	<i>-Personeli akademik efektiv duhet të përshpejtojë përparimin akademik në fitimin e gradave dhe titujve akademik dhe kualifikimit akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Infrastruktura dhe mjediset mësimore në funksion të këtij program studimi janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies në përputhje me natyrën dhe qëllimet e programit.</p> <p>Nga vizita e GVJ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Institucioni disponon mjedise të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies.</p> <p>Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit e zhvillon procesin akademik në një sipërfaqe mjaft të konsiderueshme, e cila përbëhet jo vetëm nga ambientet mësimore (salla leksioni dhe seminare), por edhe mjedise për zhvillimin e veprimtarive taktike dhe praktike. Për zhvillimin e procesit të mësimdhënies është në dispozicion një sipërfaqe prej 2078.49 m<sup>2</sup> nga e cila, 360 m<sup>2</sup> përdoret për zhvillimin e leksioneve dhe dhe 991.6 m<sup>2</sup> për zhvillimin e seminareve. Kapaciteti total i sallave të leksioneve dhe seminareve në kushte normale është 1289 poste mësimore. Në funksion të studentëve janë edhe një sërë mjedisesh mbështetëse si fjetorja, menca, salla e kinemasë, mjedise shplothëse, kafeteri/fastfood etj. Po ashtu, ka nje të përshtatshme hidrosanitare si dhe mjedise për ushtrimin e veprimtarisë së personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Ambientet për stafin akademik shtrihen në një sipërfaqe prej 331 m<sup>2</sup>. Institucioni disponon gjithashtu një sallë kompjuterash, një sallë biblioteke, si dhe mjedise për ushtrimin e aktivitetit fizik dhe praktik.</p>

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*

	<p>Në funksion të procesit të mësimdhënies, referuar lëndëve me karakter praktik janë ngritur dhe funksionojnë edhe ambiente sportive e taktike si Palestra, Pista e poligonit etj.</p> <p><i>Evidenca RVB (Shtojca tabela 16), Evidenca 24, Evidenca 24.1, Evidenca 25-25.4, Evidenca 28</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni disponon në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Mjediset e zhvillimit të procesit mësimor, si për leksione, ashtu edhe për seminaret, zyrat e mjedise të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me teknologjinë e informacionit, për realizimin e programit të studimit. Mjediset mësimore janë të paisura me mjetet e duhura didaktike dhe elektronike. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjetet e nevojshme audiovizive si PC, vidioprojektorë për të realizuar një proces sa më cilësor të mësimdhënies. Stafi akademik e zhvillon procesin mësimor duke përdorur mjetet audiovizive të instaluar në sallat mësimore. Këto mjete mund të aksesohen edhe nga studentët për realizimin sa më cilësor të prezantimeve të projekteve apo detyrave të kursit. Përveç sallave të leksioneve dhe seminareve, në funksion të programit të studimit janë dhe mjediset praktike dhe sportive të pajisura me mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarive stërvitore dhe aktiviteteve sportive.</p> <p><i>Evidenca 24, Evidenca 26.1, Evidenca 28</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni disponon mjedise të paisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit. Ambientet e mësimdhënies brenda institucionit janë të paisura me aparaturat e nevojshme në funksion të teknikave të reja të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve të këtij program studimi janë edhe mjedise të paisura me mjete të përshtatshme për të mundësuar aftësimin praktik dhe taktik të tyre. Aksesimi ndaj shërbimit të internetit si dhe teknologjia e informacionit të përdorur ka mundësuar edhe forma të bashkëveprimit on-line dhe edukimit në distancë si, zhvillimi i aktiviteteve shkencore apo trajnimeve.</p> <p>Faqja zyrtare web e AS publikon në mënyrë sistematike informacion në lidhje me, strukturën, aktet rregullatore, aktivitetet e zhvilluara, programet që ofron. Institucioni mundëson përditësimin e vazhdueshëm të këtij informacioni. Duke qënë pjesë e rrjetit të Policisë së Shtetit dhe e sitsemit të saj të informimit, lehtësohet mundësia e dhënies së</p>

*Asel Ahmeti*


*AS* 48



	<p>informacionit në kohë relae mbi aktivitete e institucionit, përfshirë edhe atyre që i referohen programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 26.1, Evidenca 27, Evidenca 28, Evidenca 29</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” nuk ka parashikuar orë laborator. Ky program është një program i veçantë, ku një pjesë e lëndëve mësimore synojnë aftësimin praktik dhe profesional të studentëve. Si i tillë, mjediset mësimore janë të paisura me infrastrukturën e përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve një sallë të veçantë kompjuterash. Nga vëzhgimi në institucion u konstatua paisja e sallave të leksioneve me mjete në funksion të teknikave të reja të mësimdhënies si p.sh projektor, poëer point etj. Në përputhje me kërkesat e programit është ngritur një infrastrukturë e përshtatshme që i shërben aftësimin praktik të studentëve në përputhje me nevojën e përgatitjes së tyre si pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit.</p> <p><i>Evidenca 22.2, Evidenca 24, Evidenca 28</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Institucioni disponon infrastrukturën, aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit në përputhje me natyrën dhe objektivat e tij.</i></p> <p><i>-Në dispozicion të studentëve janë vendosur laboratorë dhe mjedise të përshtatshme për formimin praktik në përshtatje me natyrën e programit të studimit.</i></p> <p><i>-Mjediset e zhvillimit të procesit mësimor, zyrat e mjedise të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies janë të paisura me teknologjinë e informacionit, për realizimin me sukses të programit të studimit.</i></p> <p><i>-Në përputhje me natyrën specifike të programit, është mundësuar pajisja e mjediseve mësimore me aparaturat dhe mjetet e nevojshme didaktike dhe elektronike të përshtatshme në funksion të aftësimin teorik e praktik të studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	
			<p><b>X</b></p>	

**Standardi IV.3**

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura është një nga komponentët e programit të lëndëve. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka përfshirë në syllabuset e lëndëve literaturën e detyrueshme dhe të këshillueshme. Literatura si pjesë e syllabuseve të lëndëve, si dhe materialet e tjera të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, u bëhen të njohura studentëve në filim të procesit akademik.</p> <p>Çdo modul/lëndë shoqërohet nga literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar, e cili vihet në dispozicion të studentëve në rrugë elektronike ose hard copy. Literatura mund të aksesohet dhe në bibliotekën e institucionit. Për shkak të specifikave të disa lëndëve me natyrë praktike, jo të gjitha programet e lëndëve kanë si referim literature tekste mësimore. Në këto raste, burim literature përbëjnë dispencat të cilat gjithashtu depozitohen në bibliotekën e institucionit.</p> <p>Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve/moduleve, mund të konkludohet se elementi i literaturës që paraqitet në syllabuset e ndryshme, kërkon një rifreskim dhe pasurim me literaturë bashkëkohore. Burimet e literaturës në programet e lëndëve duhet jenë më të pasura në funksion të dijeve që synohet ti jepet studentit si dhe qëllimeve akademike të programit.</p> <p><i>Evidenca 13, Evidenca RVB (Aneks tabela 14)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Çdo vit akademik, programi mësimor i nështrohet procesit të rishikimit me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së tij. Ky proces përfshin në radhë të parë departamentet si njësitë bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit. Departamentet iniciojnë vendimin për rishikimin e kurrikulës dhe përditësimin e programeve të lëndëve. Më tej vendimarrja vijon në struktura të tjera.</p> <p>Titullarët e lëndëve çdo vit akademik reflektojnë ndryshime në programet e lëndëve në përshtatje me zhvillimet e reja të fushës që mbulon lënda. Departamentet gjithashtu kanë realizuar kërkesa për blerje nga biblioteka të literaturës mbështetëse për lëndët mësimore me qëllim pasurimin e burimeve të literaturës.</p> <p><i>Evidenca 3, Evidenca 14, Evidenca 31.2-31.3.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit</p>	<p>Në mjediset e AS, është ngritur dhe funksionon biblioteka e aksesueshme për stafin akademik dhe studentët që ndjekin programin Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”. Biblioteka e AS-së organizohet dhe funksionon në përbërje të shërbimeve mbështetëse akademike, me qëllim sigurimin e literaturës së</p>

*Asse Prudente*

*JH* 50

<p>në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>nevojshme në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor - shkencor që zhvillohet në AS, si dhe formimin profesional të personelit akademik.</p> <p>Biblioteka mund të aksesohet në kushte të barabarta nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka disponon literaturë edhe në funksion të këtij programi studimi. Në tërësinë e teksteve që janë pjesë e fondit fizik të bibliotekës përfshihet si literaturë në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj. Pjesë e fondit të bibliotekës, përveç literaturës janë edhe materiale që i referohen studimeve dhe kërkimeve shkencore, trajnimeve dhe specializimeve si dhe materiale të tjera didaktike mësimore. Këto të fundit dorëzohen nga njësitë bazë në formë të printuar dhe elektronike. Studentët kanë mundësi të konsultohen me tekstet/leteraturën fizike në ambientet e bibliotekës, sipas orareve të publikuara.</p> <p><i>Evidenca 31, Evidenca 31.1, Evidenca 34.1-34.2</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, në sistemin kompjuterik të Akademisë së Sigurisë janë të regjistruar dhe janë gjendje gjithsej 6793 botime librash cilët në total përbëjnë 41522 kopje. Këto botime janë të ndarë në zhanre të ndryshëm, nga të cilët libra shkencorë 2974 botime në 19253 kopje dhe libra artistike 3789 botime në 15863 kopje. Nga totali i botimeve, në gjuhë të huaj janë 367 tekste në një total prej 3459 kopje, pjesa tjetër e fondit fizik ka në përbërje dispenca të moduleve ose lëndëve mësimore me natyrë praktike ose kurseve policore. Në total në bibliotekë ndodhen 10 dispenca me një numër prej 727 kopjesh.</p> <p><i>GVJ sugjeron shtimin e fondit fizik të literaturës që i referohet programit të studimit me literaturë bashëkohore, veçanërisht, asaj në gjuhë të juaj.</i></p> <p><i>Evidenca 34.3</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor të këtij programi studimi, institucioni ka mundësur akses për të gjithë studentët e këtij programi. Shfrytëzimi i burimeve të bibliotekës, si i literaturës në gjuhë shqipe apo në gjuhë të huaj mundësohet në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët e këtij programi. Mundësia e aksesit në bibliotekë ishte pa pagesë. Personeli përgjegjës garanton mundësinë e shfrytëzimit të burimeve të bibliotekës, pa dallim nga të gjithë studentët si dhe personali akademik për qëllime studimore dhe kërkimore. <i>Evidenca 29.4, Evidenca 31</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se biblioteka ishte e paisur me kompjutera të cilët kanë të instaluar programe dhe sisteme kompjuterike të regjistrimit të librave dhe kërkimit të</p>

*Edhe/...*

<p>dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>literaturës. Me qëllim shfrytëzmin e bibliotekes në kushte optimale në mjediset e bibliotekës janë vendosur 5 kompjutera, 22 tavolina studimi dhe 47 karrige.</p> <p>Biblioteka ka një sistem elektronik të kërkimit të literaturës si dhe akses të përdorimit sipas skedarëve elektronikë. Kjo bibliotekë është anëtare e rjetit elektronik të librarisë dixhitale U-LiBRARY. Ky rjet mundëson akses në disa date baze si Academic Search Complete, Business Source Complete etj, ku mund të aksesohet literaturë në formën e revistave/periodikeve ose librave dhe botimeve. Biblioteka është gjithashtu pjesë e sistemit Albanian Academic Search Engine (ALASE) të kërkimit dhe aksesimit të literaturës, një rjet kombëtar i kërkimit të literaturës on-line.</p> <p><i>Evidenca 35, Evidenca 36, Evidenca 11.1 (dokumentacioni shtesë), Evidenca 11. 1 (dokumentacioni shtesë)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Shërbimi në bibliotekë ofrohet në përputhje me orarin zyrtar. Gjatë këtij orari studentët i kanë të gjitha mundësitë të të konsultojnë literaturën që lidhet me programin e studimit ose material tjetër që gjendet në fondin e bibliotekës. Duke konsideruar se një pjesë e studentëve qëndrojnë në konvikte biblioteka në raste të caktuara mund të qëndrojnë e hapur edhe përtej orarit zyrtar. Kjo mundëson shfrytëzimin e bibliotekës për studentët që qëndrojnë në mjediset e AS dhe janë të akomoduar edhe me fjetje dhe strehim edhe gjatë periudhës së procesit akademik.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 34.2</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për</p>	<p>Departamentet si njësitë përgjegjëse për zhvillimin e programit ndjekin ecurinë në lidhje me fondin fizik dhe atë on-linë të bibliotekës si dhe shkallën e shfrytëzimit të saj nga personeli akademik dhe studentet e programit. Një nga burimet e kërkesave për pasurimin e fondit ekzistues të bibliotekës janë edhe ato që përcillen nga njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi në përputhje me nevojat akademike e shkencore të personelit akademik. Inicimi i kërkesave bëhet në çdo rast kur konstatohet mungesë e literatures juridike mbështetëse e cila duhet të shfrytëzohet nga stafi mësimdhënës në interes të pasurimit të programeve mësimore për studentet.</p> <p>Përditësimi i bibliotekës me literaturë bëhet kryesisht mbi bazën e donacioneve nga institucione të tilla si Akademia e Shkencave apo institucione të tjera akademike dhe shkencore.</p> <p>Nevoja për ofrimin e teksteve bashkëkohore si dhe pasurimin e literaturës së programeve mësimore shtron nevojën që</p>

*Arben Dautaj*

*[Signature]* 52

<p>pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>biblioteka të pasurohet në mënyrë periodike më tekste shkencore që i referohen programit të studimit. Gjithashtu biblioteka duhet të pasurojë fondin e saj të literaturës që aksesohet on-line nëpërmjet zgjerimit të aksesit me libraritë elektronike, të cilat përmbajnë literaturë shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 31.2, Evidenca 31.3, Evidenca RVB</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Literatura e detyrueshme si dhe ajo e këshillueshme është një nga komponentët e syllabuseve të lëndëve por në disa syllabuse burimet e literaturës duhet jenë më të pasura në funksion të dijeve që synohet ti jepet studentit si dhe qëllimeve akademike të programit.</i></p> <p><i>-Institucioni ka mundësuar akses të lirë dhe në mundësi të barabarta për shfrytëzimin e bibliotekës për të gjithë studentët e këtij program si dhe personelin akademik për qëllime studimore dhe kërkimore.</i></p> <p><i>-Biblioteka është e paisur me programe dhe sisteme kompjuterike të regjistrimit të librave dhe kërkimit të literaturës si dhe ka akses në disa data baze të kërkimit të literaturës on-line.</i></p> <p><i>-Rekomandohet pasurimi i burimeve të literaturës në programet e lëndëve si dhe referimi në burime bashkëkohore dhe cilësore, përfshirë edhe literaturën në gjuhë të huaj, në mënyrë që të mundësohet marja e dijeve të nevojshme në përputhje me objektivat e secilës lëndë/moduli.</i></p> <p><i>-Përditësimi i vazhdueshëm i pasurimi i fondit fizik të bibliotekës me literaturë bashkëkohore në përputhje me në kërkesat e programit të studimi dhe nevojat akademike e shkencore të personelit akademik.</i></p> <p><i>-Zgjerimi fondit digjital nëpërmjet ritjes së aksesit në baza bazet të literaturës on-line si dhe bibliotekave on-line.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<b>X</b>	

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit në AS është pjesë e sistemit të integruar me Policinë e Shtetit dhe mundëson ndjekjen e ecurisë së studentëve deri në punësimin e tyre në strukturat e Policisë së Shtetit. Brenda institucionit. Sekretaria Mësimore siguron administrimin e të dhënave që lidhen me studentët që nga që momenti i regjistrimit deri në diplomim.</p> <p>Sekretaria mësimore, administron dokumenta të tillë si regjistrin themeltar, regjistrin e rezultateve të provimeve, si dhe regjistrin e rezultatit të diplomimit të studentëve. Sekretaria mësimore prodhon, administron dhe ruan gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me shlyerjen e detyrimeve sipas programit, procesverbalet e provimeve të zhvilluara, apo çdo lloj dokumenti tjetër (vërtetimi, vendime ekuivalentimi, transferim kreditues, etj.) që lidhet me veprimtarinë mësimore të fakultetit. Këto të dhëna shërbejnë edhe për relaizimin e analizave statistikore. Nga vizita pranë Sekretarisë Mësimore u konstatua se sekretaria e administron informacionin si në format elektronik, ashtu edhe në format shkresor.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 3</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit që administron informacionin dhe dokumentacionin si dhe aktivitetin e personalit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit, është pjesë përbërëse e e sistemit të Policisë së Shtetit. Administrimi i dokumentacionit për personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ realizohet nga Zyra e Personelit. Pranë kësaj zyre administrohen dosjet e personelit me të dhënat përkatëse. Këto dosje përmbajnë të dhëna të detajuara, për secilën nga kategoritë e personalit si dhe përditësohen në mnyrë të vazhdueshme.</p> <p>Të dhënat e studentëve dhe të kursantëve, ruhen dhe përpunohen nga AS-ja dhe njësitë kryesore, në përputhje me parimin e besueshmërisë dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve/kursantëve, nga AS-ja dhe njësitë kryesore të saj, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Evidenca 1 Statuti, Evidenca 3 Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar</p>	<p>AS është pjesë e sistemit të integruar të menaxhimit të informacionit të Policisë së Shtetit. Si e tillë, ajo mundëson</p>

<p>platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>menaxhimin e informacionit nëpërmjet platformave që përdoren edhe nga Policia e Shtetit. Për sa i takon këtij program studimi, aksesit në informacion dhe komunikimi ndërmjet personelit akademik, atij administrativ dhe studentëve realizohet me përdorimin e postës elektronike, nëpërmjet adresave zyrtare të emailit.</p> <p>Në mungesë të moduleve dhe platformave që mundësojnë menaxhimin e dedikuar të informacionit si për perdidagogët dhe studentët e përfshirë në program, si forma të menaxhimit të informacionit, institucioni përdor kyesisht komunikimin nëpërmjet emailit zyrtar ose aksesit në faqen eeb të institucionit.</p> <p><i>GVJ sugjeron krijimin e një sistemi të informatizuar të menaxhimin të informacionit i cili i dedikohet bashkëveprimit midis studentëve dhe pedagogëve.</i> Përdorimi i këtij sistemi do të mundësonte marrjen në kohë reale të informacionit mbi sillabuset e lëndëve, programet mësimore, leksionet apo materiale të tjera të përcjella nga pedagogët si dhe aspekte që lidhen me sistemin e vlerësimit dhe angazhimin në lëndët përkatëse. Përdorimi i platformave të tilla i shërben komunikim në kohë reale midis personelit akademik dhe studentëve për një mbarëvajtje më të mirë të procesit akademik edhe rritjes së shkallës e transparencës në procesin e informimit të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Aktet rregulatore parashikojnë regullime në lidhje me prodhimin dhe administrimin e dokumentacionit nga strukturat e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit. Në këto akte janë parashikuar në detaje aspekte që lidhen me administrimin shkresor të korespondencës, ruajtjen fizike, asgjësimin apo arkivimin e dokumentave. Njëkohësiht kanë përcaktuar edhe detyrat e strukturave përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të tilla si: sekretaria mësimore, dekanati, departamentet, pedagogët.</p> <p>Platformat që përdoren për komunikim dhe shkëmbim informacioni mund të monitorohen në çdo kohë pasi hedhja e çdo të dhënë le gjurme elektronike. Kjo mundëson marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për qëllim monitorimi ose qëllime të tjera që lidhen me mbarëvajtjen dhe administrimin e procesit mësimor në këtë program studimi. <i>Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në</p>	<p>Në faqen zyrtare të AS pasqyrohen në mënyrë të detajuar një sërë aspektesh mbi organizimin e programeve të studimeve që ofron institucioni, kriteret e përzgjedhjes së studentëve në këtë program studimit, marrjen e informacionit mbi sillabuset e lëndëve, programet mësimore dhe aspekte të tjera që lidhen me</p>



faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	zhvillimin e procesit akademik. Pjesë e përmbajtjes së kësaj faqeje janë edhe të dhënat për stafin akademik, aktivitetet shkencore etj.			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Sistemi i menaxhimit në AS është pjesë e sistemit të integruar me Policinë e Shtetit nëpërmjet të cilit institucioni mundëson ndjekjen e ecurisë së studentëve deri në punësimin e tyre në strukturat e Policisë së Shtetit.</i></p> <p><i>-Institucioni administron dhe përditson dokumentacionin për personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e të dhënave.</i></p> <p><i>-Sistemi i administrimit dhe menaxhimit të informacionit mundëson marjen në kohë reale të informacioni të nevojshëm për qëllime monitorimi ose qëllime të tjera që lidhen me mbarëvajtjen dhe administrimin e procesit mësimor në këtë program studimi.</i></p> <p><i>-GVJ sugjeron përdorimin e platformave të dedikuara për shkëmbimin e informacionit midis personelit akademik dhe studentëve si mënyra më e mirë për ritjen e aksesit në informacion dhe mbarëvajtjen e programit mësimor.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për</p>	<p>Çdo vit buxhetor AS pasqyron dhe administron të dhënat në lidhje me buxhetin duke i dhënë prioritet financimit të nevojave parësore në nivel institucional. AS harton çdo vit plane buxhetore afatmesëm, si pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Institucioni harton projekt buxhetin e tij ku pasqyron shpenzimet si dhe të ardhurat dhe burimet e tyre. Raportimi i veprimtarisë financiare paraqitet si një i tërë dhe nuk i referohet programeve të veçanta.</p> <p>Programi vjetor buxhetor i AS është pjesë e programit buxhetor të Policisë së Shtetit. Si rjedhojë, institucioni ka</p>

*[Signature]*

*[Signature]* 56



<p>të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>hartuar plane financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare me qëllim mbarëvajtjen financiare në nivel institucional dhe nuk i referohen specifikisht këtij program studimi. Njësitë bazë në kuadrin e hartimit të projekt buxhetit, propozojnë dhe bëjnë kërkesa për fonde buxhetore që i referohen shpenzimeve lidhur me mbarëvajtjen e programeve mësimore. Institucioni ka ngritur struktura të dedikuara ndaj mkikqyrjes së veprimtarisë financiare në nivel institucional si Bordi i Administrimit dhe Administratori.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 38, Evidenca 38.1-38.3</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Institucioni harton plane financimi çdo periudhë buxhetore. Raportet financiare, përfshirë edhe planet e financimit janë hartuar në rang institucional referuar specifikës së ushtrimit të aktivitetit të institucionit si pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit. Në planet e financimit pasqyrohen detaje që i referohen ndarjes së burimeve financiare në formën e shpenzimeve dhe të të ardhurave. Pasqyrimi i këyre të dhënave nuk është i kategorizuar sipas programeve që ofron institucioni.</p> <p>Në raportet financiare të institucionit pasqyrohen të dhëna mbi shpenzimet financiare që i referohen pagave të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, shpenzimet operative që i referohen mirëmbajtjes së mjediseve dhe teknologjisë në mbështetje të procesit mësimor, ato për kancelari, shpenzimet për veprimtari shkencore apo publikimi etj. Pranë zyrës së financës administrohet dokumentacioni në lidhje me detyrimet financiare, pagat e personelit, etj. Në zyrën e personelit administrohen kontratat për pedagogët part-time të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 38.1-38.3</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni çdo vit harton dhe dokumenton gjendjen financiare të tij, kontabilizimin e shpenzimeve të kryera dhe të ardhurave të gjeneruara. Njëkohësisht, në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, i nënshtrohet procesit të auditimit të përvitshëm të situatës financiare të tij. Institucioni zbaton detyrimet që lidhen me monitorimin e situatës financiare, auditimin dhe raportimin, duke mundësuar në këtë mënyrë transparencën financiare. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në AS, kryhet nga struktura e auditimit të Policisë së Shtetit dhe ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Ky kontroll konsiston në auditim financiar, logjistik dhe administrativ. Në</p>

	<p>raportet e auditit pasqyrohet opinioni i tyre mbi transparencën financiare si dhe pasqyrimin e të dhënave financiare të institucionit. Institucioni është angazhuar me veprime konkrete në marjen e masave për plotësimin e rekomandimeve dhe masave të lëna nga auditet e mëparshme. Këto masa përfshijnë edhe ngritjen e grupeve të punës si dhe hartimit të planeve të veprimit që i referohen menaxhimit dhe kontrollit financiar.</p> <p><i>Evidenca 39</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse të AS-së, informojnë dhe raportojnë, aspekte që lidhen me mbi realizimin e buxhetit. Një nga funksionet e administratorit, pas informimit mbi raportet vjetore të auditimit të Policisë së Shtetit, është marrja masave për përmirësimin e tij dhe hartimit të deklaratës vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.</p> <p>Hartimi i projektbuxhetit vjetor, bëhet edhe mbi bazën e propozimeve të njëjësive kryesore dhe të njëjësive bazë, mbështetur në planin buxhetor afatmesëm të tij. Në kuadrin e hartimit të projekt buxhetit, Departamentet evidentojnë kërkesat për fonde buxhetore në lidhje me aspekte që i referohen mbarëvajtjes së programit të studimit. <i>Evidenca 1</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit BA në Siguria dhe Hetimi është një program që fiancohet nga buxheti i shtetit. Si i tillë, ai siguron një qëndrueshmëri financiare gjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit, si dhe mundëson kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Duke qënë se burimi i financimit është buxheti i shtetit, raportet financiare nuk përmbajnë pasqyra të hollësishme financiare mbi të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare nga studentët.</p> <p>Institucioni harton strategji të menaxhimit të riskut për të identifikur dhe vlerësuar efekte e ngjarje që mund të kenë ndikim të dëmshëm në përmbushjen e objektivave të tij. Administratori i AS-së për aspekte të aktivitetit të tij, i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të A.S-së, në përfundim të çdo viti akademik. Në përfundim të vitit, AS-ja i raporton Drejtorit të Përgjithëm të Policisë dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike mbi realizimin e buxhetit, realizimin e objektivave, gjendjen financiare e logjistike, rishikimin e limitit organik, si dhe nevojat për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 39</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare si dhe administron dokumentacion në lidhje me aktivitetin e tij financiar.</i></p> <p><i>-AS realizon raportimin financiar si dhe harton plane financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare me qëllim mbarëvajtjen financiare në nivel institucional.</i></p> <p><i>-Në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, institucioni i nënshtrohet procesit të auditimit të përvitshëm të situatës financiare të tij si dhe zbaton detyrimet që lidhen me auditimin dhe raportimin, duke mundësuar në këtë mënyrë transparencën financiare.</i></p> <p><i>-Si një program që financohet nga buxheti i shtetit, programi i studimit BA në Siguria dhe Hetimi siguron një qëndrueshmëri financiare gjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit, si dhe mundëson kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Organizmi i këtij program studimi mbështetet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, VKM nr. 185, datë 25.02.2015 “Për funksionimin dhe organizimin e Akademisë së Sigurisë”, VKM nr. 881 datë

*[Signature]*

*[Signature]* 59

<p>legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>28.10.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”.</p> <p>Në përputhje me rregullimet ligjore, janë hartuar nga institucioni edhe aktet rregullatore të brendshme që prashikojnë politika dhe procedura që i referohen ecurisë së studentit që nga momenti i regjstrimit deri në diplomim. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Institucioni disponon të dhëna të hollësishme mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim, përfshirë numrin e të regjistruarve, kalueshmërinë, notën mesatare etj.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti, Evidenca 3, Evidenca 3.1, Evidenca 10, Evidenca 10.1, Evidenca 45</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Aket rregullatore të institucionit kanë parashikime specifike që mundësojnë barazi dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për student si dhe studentët e programit të studimit. Respektimi me rigorozitet i këtyre procedurave në përputhje me rregullimet ligjore gjatë gjithë procesit akademik, mundëson respektimin e parimit të barazisë dhe garantimit të të drejtave për të gjithë pjesëmarrësit në këtë program.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti, Evidenca 3, Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pranimi i studentëve në AS kryhet sipas procedurave, standardeve dhe kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë, në politikat e arsimit të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, si dhe sipas nevojave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese. Një nga specifikat janë kriteret e posaçme të përzgjedhjes së studentëve që lidhen me natyrën e veçantë të këtij programi studimi.</p> <p>Në programin e studimit “Bachelor” për Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, pranohen të gjithë kandidatët që kanë përfunduar studimet në Kolegjin e Lartë Profesional të Policisë dhe që plotësojnë edhe kritere të tjera të parashikuar në aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Përveç kriterëve me karakter të përgjithshëm, kandidatët pranohen në këtë program edhe dhe sipas kriterëve specifike që miratohen nga Senati Akademik. Pranimi në një nga programet e studimit në Akademinë e Sigurisë, bëhet nëpërmjet procesit të konkurrimit. Ky proces përmban një sërë testesh të cilët synojnë të verifikojnë e vlerësojnë dijet,</p>

*Ades Paul*

*60*

	<p>njohuritë dhe zhvillimin intelektual, aftësitë dhe cilësitë e konkurrenteve. AS-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit "Bachelor" në "Siguria dhe hetimi".</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 10, Evidenca 3, Evidenca 13</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Procedurat dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen, përparimin, transferimet apo njohjen e studimeve janë të qarta dhe të kuptueshme. Këto kritere u bëhen të njohura të interesuarve apo kandidatëve për student në përputhje me procedurat e parashikura në aktet rregullatore. Aktet rregullatore të brendshme përmbajnë informacione të detajuara në lidhje me kriteret e përparimit, kohëzgjatjen e studimeve, transferimet vlerësimin e dijeve dhe diplomimit.</p> <p>Programet mësimore si dhe sylabuset e lëndëve kanë përmbajtje mjaft të detajuar që i shërben procesit informues. Në përmbajtjen e programit gjenden të gjitha elementët mbi objektivat, strukturën e programit, kohëzgjatjen e studimeve si dhe sylabuset e lëndëve. Sylabuset e lëndëve përmbajnë informacion të detajuar dhe të kuptueshem mbi detyrimet e studentëve, format e kontrollit dhe vlerësimit të lëndës.</p> <p>Nga vizita në institucion ekspertët e GVJ konstatuan se njoftimet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor apo çdo aktiviteti të zhvilluar nga instiucioni afishohen në stenda në vende të dukshme dhe aksesueshme nga studentët. Institucioni publikon informacion në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi edhe në faqen e tij zyrtare( <a href="http://www.akademia.asp.gov.al">www.akademia.asp.gov.al</a>) ose në rrjetet sociale. Njoftimet përkatëse bëhen edhe në Drejtorinë e Policisë së qarqeve.</p> <p><i>Evidenca 3, Evidenca 3., Evidenca 8, Evidenca 13, Evidenca 40</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kuotat si dhe procedurat e regjistrimit publikohen dhe u vihen në dispozicion të interesuarve përpara fillimit të vitit akademik. AS-ja bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe me strukturat vendore të saj, për të informuar në mënyrë të plotë të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të këtij program studimi. Me qëllim lehtësimin e aksesit në informacion, institucioni publikon njoftime në faqen e tij zyrtare. Në faqen zyrtare të institucionit</p>

*Arbes*

*61*

	<p>(www.akademia.asp.gov.al) publikohen gjithashtu edhe programet mësimore. Informacioni i nevojshëm mund të aksesohet lehtësisht edhe pranë sekretarisë mësimore. Njëkohësisht informacioni në lidhje me programet e studimit mund të aksesohet edhe në formën e broshurave informuese apo fletë palosjeve. <i>Evidenca 10.1, Evidenca 40, Evidenca 41</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni në aktet rregullatore ka sanksionuar kriteret e përgjithshme të pranimit për këtë program studimi. Si një program që përgatit specialist në fushën e rendit dhe sigurisë publike, pjesëmarrja në këtë program i nështrohet një konkurimi ku testohen si aftësitë fizike, ashtu edhe ato intelektuale të kandidatëve. Megjithatë në politikën e tij institucioni i ka kushtuar vëmendjen e duhur edhe kategorive të veçanta. AS zbaton politikën që nxisin pjesëmarrjen e femrave në këtë program studimi.</p> <p>Institucioni analizon dhe përpunon të dhëna në lidhje me pjesëmarrjen mbi bazë gjinore, çka evidenton rëndësinë dhe mbështetjen që i jepet pjesëmarrjes së studenteve femra. Kuota të veçanta janë dedikuar për fëmijët e policëve të rënë në krye të detyres. Mbështetje dhe një kujdes gjithashtu i veçantë i kushtohet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të minoriteteve të ndryshme si ata, rom, egjiptian etj.</p> <p><i>Evidenca 42, Evidenca 43, Evidenca 44</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit parashikojnë mundësinë e transferimit të krediteve ose të njohjes së pjeshme të lëndëve të kryera në shtete të tjera. Kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të lëndëve, janë të përcaktuara në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Një nga objektivat që ky program studimi synon, është: Parashikimi i transferimit, njohjes dhe ekuivalentimit të krediteve të fituara në institucione të tjera të larta arsimore, unifikimit të moduleve apo lëndëve mësimore, si dhe bashkëpunimit me institucionet e larta arsimore, brenda e jashtë vendit.</p> <p>Akademia e Sigurisë ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të së njëjtit cikël studimi dhe për kredite të fituara në programe të tjera studimi, brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet ekuivalentimit të pjesëve ose programeve të plota të studimeve nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtit ose të ngjashëm në një institucion homolog. Për këtë qëllim pranë Fakultetit të Sigurisë e Hetimit është ngritur dhe funksionon një strukturë e veçantë, Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit. Rregulloret e brendshme përcaktojnë detaje në</p>


	lidhje me procesin e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve/krediteve me qëllim transferimin e studimeve pranë AS. <i>Evidenca 1, Statuti Evidenca 13</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Si një institucion shtetëror, AS zbaton legjislacionin në fuqi në lidhje me politikat e mbështetjes dhe trajtimit të shtresave në nevojë ose kategorive të veçanta. Duke qënë efektive të Policisë së Shtetit, studentët e këtij program studimi trajtohen me pagë gjatë kohëzgjatjes së studimeve. Njëkohësisht për kategorinë që vjen nga strukturat vendore të policisë mundësohet akomodimi në mjediset e AS. Institucioni zbaton politika mbështetëse për kategori të veçanta si fëmijët e rënë në krye të detyrës, si dhe përfaqësuesve të pakicave apo minoritetve të ndryshme.  <i>Evidenca 42 Evidenca 44</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tij të brendshme.</i></p> <p><i>-Procedurat dhe kriteret e përgjithshme dhe të posaçme që përdor institucioni për përzgjedhjen e kandidatëve dhe përparimin akademik të studentëve janë të qarta dhe të kuptueshme.</i></p> <p><i>-AS-ja në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit zbaton të gjitha procedurat e nevojshme për të informuar në mënyrë të plotë të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të këtij programi studimit dhe për të lehtësuar aksesin në informacion.</i></p> <p><i>-Në politikat e tij institucioni i ka kushtuar vëmendjen e duhur kategorive të veçanta si dhe ka zbatua politika mbështetëse për pjesëmarrjen e tyre në këtë program studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

*Aleksander...*

*[Signature]* 63

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një kuadër rregullator të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. Aktet rregullatore të brendshme përmbajnë elementë informues mbi përzgjedhjen e studentëve, sistemin e përparimit dhe vlerësimit të dijeve, diplomimit si dhe transferimit të krediteve.</p> <p>Programet e lëndëve gjithashtu përmbajnë informacionin të detajuar didaktik dhe akademik për studentët. Në programet e lëndëve përcaktohen kriteret të detajuara të përparimit akademik të tilla si: detyrimet për frekuentimin e procesit mësimor në auditor (leksione, seminare), shlyerja e projekteve, provimet e ndërmjetme apo pjesore, mënyra e shlyerjes në përfundim të lëndës pikët e nevojshme për vlerësimin kalues në secilën lëndë. Studentët njihen me përmbajtjen dhe komponentët e programit të çdo lënde në fillim të procesit mësimor. Njëkohësiht aktet rregullatore të institucionit janë të aksesueshme nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të tij. Studentët mund të marrin të gjithë informacion e nevojshme në lidhje me aspekte të procesit mësimor dhe përparimit akademik edhe pranë Sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 13, Evidenca 3. Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>AS-ja si institucion i arsimit të lartë, ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të së njëjtit cikël studimi, brenda AS-së apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Institucioni garanton mundësinë e njohjes dhe njehsimit të periudhës së studimit dhe detyrimeve të programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve, përcaktohen në rregulloren e AS-dhe atë të këtij program studimi, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi mbi arsimin dhe kërkimin në institucionet e arsimit të lartë. Studentët njihen me procedurat dhe kuadrin rregullator të programit mësimor që në momentin e parë të regjistrimit. Kriteret dhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të lëndëve, janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe atë të këtij program studimi. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm edhe pranë Sekretarisë Mësimore. <i>Evidenca 13, Evidenca 3</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit dhe në veçanti, “Rregullorja e programit të studimit “Bachelor” në “Siguria dhe hetimi”, parashikon kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi. Rregullorja e programit të studimit</p>





<p>dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>përcakton rregullat mbi të cilat bazohet procesi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve të përfuara përgjatë procesit mësimor. Ajo parashikon rregullime të detajuara lidhur me format e kontrollit të njohurive, shlyerjes së provimeve, riprovimeve, sistemit të vlerësimit etj.</p> <p>Njëkohësisht studenti e merr këtë informacion edhe nga syllabusi i lëndës. Programet e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e vlerësimit të dijeve, si dhe komponentët e vlerësimit. Në programet e lëndëve përcaktohen format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi për secilin komponent. Kontrolli i njohurive përbëhet nga disa komponentë dhe realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Në fillim të çdo semesri, studentët informohen nga pedagogët mbi përmbajtjen dhe komponentët e secilit nga syllabuset.</p> <p>Metodologjia dhe struktura e hartimit të testeve janë gjithashtu pjesë e informacionit që merret nga studentët, përmes stafit akademik. Në kuadrin e detyrave që ushtrojnë pedagogët përfshihet edhe konsultim me studentët, sipas nevojave dhe kërkesës së tyre, në funksion të përvetësimit sa më të plotë të programit mësimor. Nga takimi me studentët, rezultoi se ato janë të informuar mbi komponentët e programit të studimit të tyre që lidhen me vlerësimin e dijeve dhe njohurive të marra në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 3. Evidenca 3.1, Evidenca 13</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit kanë parashikuar rregullime mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit. Rregullorja e instiucionit si dhe ajo e programit të studimit përcaktojnë si forma të diplomimit të studentëve atë; me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome për studentët me një prag të caktuar të notës mesatare. Pragu i notës mesatare përcaktohet nga Dekanati.</p> <p>Regulloret e brendshme përcaktojnë detyrimet e njësive përgjegjëse të këtij program studimi mbi orientimin e studentëve mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës si dhe asistimin në këtë proces. Pedagogët e caktuar nga departamenti udhëzojnë studentët për përgatitjen e temave të diplomës. Aktualisht, në përfundim të programit të studimit “Bachelor” në “Siguria dhe hetimi”, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit mbrojtja e diplomës nuk realizohet me punime diplome, por vetëm me një provim përfundimtar.</p> <p>Studentët asistohen në këtë process nëpërmjet këshillimit dhe orientimit nga pedagogët e lëndëve. Atyre u vihet në dispozicion një listë pyetjesh orientuese të cilat ndihmojnë në</p>

	<p>zhvillimin me sukses të provimit përfundimtar. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 13, Evidenca 3, Evidenca 3.1</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përpara fillimit të çdo viti akademik merr masat e nevojshme për realizimin e veprimtarive informuese me qëllim njohjen me programet e studimit. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kuotat si dhe procedurat e regjistrimit publikohen dhe u vihen në dispozicion të interesuarve përpara fillimit të vitit akademik.</p> <p>Takime informuese zhvillohen edhe në mjediset e institucionit ku shpërndahen edhe fletëpalosje për të interesuarit mbi të dhënat e programit të studimit. Me qëllim lehtësimin e aksesit në informacion, institucioni publikon njoftime në faqen e tij zyrtare. (<a href="http://www.akademia.asp.gov.al">www.akademia.asp.gov.al</a>). Këto informacione publikohen gjithashtu edhe në rrjetet sociale apo media.</p> <p>Informimi i të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit realizohet edhe nëpërmjet publikimit të broshurave informuese apo shpërndarjes së fletë palosjeve. Për qëllime informimi institucioni bashkëpunon edhe me strukturat e Policisë së Shtetit.</p> <p><i>Evidenca 4, Evidenca 9 (dokumentacioni shtesë)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Institucioni ka hartuar një kuadër rregullator të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</i></p> <p><i>-Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi mbi arsimin e lartë.</i></p> <p><i>-AS ka parashikuar dhe zbaton procedura mbi informimin e studentëve mbi komponentët e programit të studimit. Nga vizita në Institucion dhe takimi me studentët, rezultoi se ato ishin të informuar mbi organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi V.3**

*Arben Ahmeti*

*X* 66

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>AS mundëson për studentët e këtij programi informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit nëpërmjet një sërë burimesh si Departamenti, Sekretaria Mësimore, ose nëpërmjet informacioneve të publikura etj. Departamentet e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit si njësitë bazë përgjegjëse për zbatimin e programin të studimit, kanë në përbërje të gjitha kapacitetet njerëzore për tu mundësuar studentëve informacionin e nevojshëm mbi komponentët e programit.</p> <p>Në fillim të çdo lënde/moduli studentët marrin informacion nga pedagogët e lëndës në lidhje me komponentët e syllabuseve si dhe detyrimet në raport me lëndën. Zbatimi i këtij detyrimi u konfirmua edhe nga studentët gjatë takimit të zhvilluar me GVJ. Njëkohësisht Zyra e Sekretarisë në kuadrin e kompetencave të saj, siguron informacionin e nevojshëm për studentët. Këtë informacion studentët mund ta aksesojnë edhe në faqen zyrtare të AS.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Programi mësimor i këtij cikli studimi përmban informacione të detajuara mbi modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion iu jepet studentëve që në momentet e para të kontaktit me institucionin. Institucioni i publikon informacionet në lidhje me programet e studimit që ofron edhe në faqen zyrtare të tij.</p> <p><i>Evidenca 10.1, Evidenca 13</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>AS si Institucioni ku zhvillohet ky program studimi, është pjesë përbërëse e strukturës së Policisë së Shtetit. Synim kryesor i këtij programi është: Plotësimi i nevojave që ka Policia e Shtetit për resurse të afta profesionalisht dhe specialistë me nivel të lartë kulturor të përputhur me zhvillimin social e ekonomik të vendit.</p> <p>Mbarimi i studimeve pranë AS mundëson vazhdimësinë e karrierës profesionale të studentëve pranë strukturave të Policisë së Shtetit. Mbas mbarimit të studimeve në këtë program studimi, studentët e diplomuar transferohen dhe caktohen në detyrë në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin mbi Policinë e Shtetit. Ky sistem mundëson edhe ruajtjen e lidhjeve të vazhdueshme të studentëve me AS si dhe mbështetjen e tyre në vlerësimin e procesit mbas diplomimit</p>

	për të përmirësuar kurikulat dhe në tërësi cilësinë e mësimdhënies.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Studentët marrin informacion të detajuar që nga momenti i regjistrimit në programin “Bachelor” në “Siguria dhe hetimi” e deri në përfundim të studimeve të këtij programi. Nëpërmjet strukturave të dedikuara studentëve iu vihet në dispozicion çdo informacion i nevojshëm mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet çdo herë që kërkojnë të informohen.</p> <p>Përgjegjësit e grupeve prane departemnteve mbajnë kontakte të ngushta me studentët dhe përcjellin informacionet e nevojshme mbi organizimin e procesit mësimor. Pedagogët e departamentit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor që në orën e parë të prezantimit. Ata mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët dhe u përcjellin njoftime gjatë procesit të mësimdhënies ose nëpërmjet postës elektronike. Çdo njoftim apo lajmërim mbi organizimin e procesit mësimor u njoftohen studentëve edhe përmes sekretarisë mësimore. Informacioni mbi akte rregulatore dhe aktivitete shkencore referuar programit të studimit mundësohet edhe nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të AS.</p> <p><i>Evidenca 27, Evidenca 53, Evidenca 65</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Aksesi në informacion mbi këtë program studimi mundësohet nëpërmjet një sërë formash të shpërndarjes së informacionit, si më sipër (<i>kriteri 4</i>).</p> <p>AS nuk ka në dispozicion platforma elektronike të cilat do të mundësonin, marrjen e informacionit në kohë reale mbi aspekte që lidhen me programin e studimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Për sa i takon komunikimit në distancë, informimi i studentëve mbi komponentët lidhur me programin dhe procesin mësimor realizohet nëpërmjet postës elektronike. Gjithashtu, informacioni mbi programin e studimit mund të aksesohet në faqen zyrtare të Institucionit.</p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-AS ka në përbërje struktura të dedikuara si dhe përdor të gjitha kapacitetet e nevojshme për tu mundësuar studentëve të gjithë informacionin mbi komponentët e programit të studimit.</i></p> <p><i>-Mbarimi i studimeve pranë AS mundëson vazhdimsinë e karrierës profesionale të studentëve pranë strukturave të Policisë së Shtetit.</i></p> <p><i>-GVJ sugjeron që Institucioni të orinetohet drejt përdorimit të platformave elektronike si një nga mënyrat për të përmirësuar</i></p>

	në vijimësi sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe mundësinë e komunikimit në kohë reale edhe në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Institucioni disponon dhe administron të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi si dhe ata të diplomuar. Ky dokumentacion administrohet pranë Sekretarisë Mësimore. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se institucioni disponon statistika vjetore të detajuara për numrin e të diplomuarve, në këtë program studimi. Institucioni disponon gjithashtu të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit sipas viteve, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p><i>Evidenca 45</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Si struktura përgjegjëse, Sekretaria Mësimore administron të dhënat që lidhen me çdo vit akademik mbi studentët. Dokumentacioni i administruar nga institucioni përmban të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomim. AS administron të dhëna të tilla që në fazat e para të fillimit të studimeve pranë këtij institucioni. Referuar të dhënave statistikore në këtë program studimi dhe vizitës në sekretarinë mësimore numri i studentëve të regjistruar në tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në vitin akademik 2020-2021 70 studentë;</li> <li>- në vitin akademik 2021-2022 96 studentë;</li> <li>- në vitin akademik 2022-2023 95 studentë;</li> </ul> <p>Dokumentacioni i administruar nga sekretaria ka të dhëna mbi numrin e studentëve, në vite të regjistruar në këtë program, numrin e studentëve që ndjekin këtë program si dhe tërheqjet</p>

*[Signature]*

*[Signature]*

	<p>nga programi apo mospërfundimi i tij. Pranë sekretarisë depozitohet gjithashtu dokumentacioni i personelit akademik mbi vijueshmërinë e procesit mësimor, frekuentimin si dhe vlerësimin e provimeve. Ky dokumentacion shërben si bazë për përpunimin e të dhënave statistikore.</p> <p><i>Evidenca 45</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni administron, sipas rregullave në fuqi për arkivat dhe dokumentat zyrtare, të gjitha dokumentat që lidhen me studentin dhe procesin mësimor. Kompetencat dhe detyrat e strukturave përgjegjëse për administrimin e të dhënave të studentëve përcaktohen edhe në rregulloret dhe aktet e brendshme të institucionit. Sistemi i menaxhimit të informacionit është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar pasi është pjesë e sistemit të menaxhimit të Policisë së Shtetit. Administrimi i dokumentacionit mbi të dhënat e studentëve realizohet në dy forma, në formatin dokumentar dhe atë elektronik. Këto të dhëna ruhen në formatin dokumentar në formën e regjistrave apo procesverbaleve të notave. Administrimi i të dhënave në sekretari mundësohet në format elektronik nëpërmjet menaxhimit elektronik. Format e administrimit garantojnë sigurinë e të dhënave dhe i bëjnë ato lehtësisht të aksesueshme.</p> <p><i>Evidenca 3, Evidenca 3.1, Evidenca 46, Evidenca 47</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimor, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni kryen kontrole periodike pranë sekretarisë mësimore si struktura përgjegjëse për pasqyrimin dhe administrimin e dokumentacionit në lidhje me studentët. Ky kontroll realizohet në mënyrë sistematike, të paktën për çdo vit akademik. Rezultatet e kontrollit janë pjesë e analizave vjetore që realizohen që nga niveli i njësive bazë, deri në nivelin e institucionit. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit i nënshtrohet verifikimit nga strukturat kompetente pasi është pjesë e sistemit të Policisë së Shtetit.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 48</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në</p>	<p>Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit administron të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe nxjerr</p>


*Arben Prunçaj*

*70*

<p>hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>konkluzione mbi cilësinë nëpërmjet notës mesatare dhe kalueshmërinë për këtë program studimi.</p> <p>Referuar statistikave, nota mestare në hyrje ndër vitet akademike rezultoi:</p> <p>për vitin akademik 2019-2020 është 8.14;</p> <p>për vitin akademik 2020-2021 është 7.66;</p> <p>për vitin akademik 2021-2022 është 7.73;</p> <p>Institucioni për këtë program studimi administron edhe të dhëna mbi ecurinë akademike të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimit, deri në diplomim. Këto të dhëna administroheshin si mbi baza semesrale, ashtu edhe mbi bazë vjetore. Departamentet çdo vit akademik analizojnë cilësinë e përmbushjes së programit mësimor dhe aktiviteteve kërkimore shkencore. Pjesë e analizës vjetore janë edhe aspektet që lidhen me rezultatet e provimeve, shkallën e kalueshmërisë si dhe notën mesatare. Këto të dhëna administrohen dhe pasqyrohen në formën e të dhënave në nivel institucioni. Për sa i takon punësimit, institucioni mundëson lehtësisht kontaktet me të diplomuarit edhe pas përfundimit të programit, pasi studentët e këtij program janë efektivë të Policisë së Shtetit.</p> <p><i>Evidenca 5, Evidenca 45, Evidenca 48</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Institucioni disponon dhe administron të dhëna statistikore mbi studentët që ndjekin këtë program studimi si dhe ata të diplomuar.</i></p> <p><i>-Ai i administron këto të dhëna nëpërmjet dokumentacionit si dhe sitemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, i cili është i sigurt dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar.</i></p> <p><i>-Nëpërmjet të dhënave statistikore institucioni analizon profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe nxjerr rezultate mbi cilësinë dhe kalueshmërinë për këtë program studimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e**



**përmirësimet të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>AS ka respektuar kriteret e legjislacionit në fuqi dhe akteve të veta rregullatore në lidhje me angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në një sërë strukturash si: Senati Akadamik, Këshilli i Etikës dhe NJSBC. Ata janë përfshirë dhe përfaqësohen edhe në Komisionet e Përhershme të ngritura nga AS si Komisioni i përhershëm i Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilesisë apo Komisioni i përhershëm i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët/kursantët sipas parashikimeve të Statutit. Njëkohësisht është ngritur dhe funksionon Këshilli i Studentëve si një organ përfaqësues i interesave të tyre.</p> <p><i>Evidenca nr. 5, Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në organet përfaqësuese të sipërpërmendura mundëson një përfaqësim real të interesave të tyre në këto organe dhe përfshirjen në procesin e vendimmarrjes, apo vlerësimit të procesit akademik. Institucioni mundëson përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të programit mësimor, të mësimdhënies dhe stafit akademik nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, duke mundësuar marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre. Gjithashtu, Departamenti mundëson përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet mbledhjeve të hapura kur diskutohen çështje që lidhen me procesin mësimor.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 62, Evidenca 62.1</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Procedurat e rishikimit dhe përmirësimit të programit mundësojnë përfshirjen dhe kontributin e studentëve në këtë proces. Vlerësimi, bëhet në bazë të metodës së tërthortë të vlerësimit, nëpërmjet pyetësorëve. NJSBC në kuadrin e detyrave të saj, duhet të hartojë dhe të organizojë çdo fund semestri për studentët pyetësorin për cilësinë e mësimdhënies në të gjitha programet që AS-ja ofron, si dhe të raportojë përpara Senatit Akadematik për rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Formularët e vlerësimit nga studentët, përmbajnë edhe elementë që lidhen me programin e studimit dhe programet e secilës lëndë. Kjo u mundëson studentëve të japin opinionet e tyre mbi cilësinë e programit dhe të sugjerojnë përmirësime. Këta pyetësorë mund të bëhen objekt diskutimi dhe reflektimi në departament, përfshirë edhe propozimet konkrete për</p>

*Arise Prunçev*

*JP* 72



	<p>përmirësimin e përmbajtjes së programeve mësimore. Marja e mendimit mundësohet edhe për studentët e diplomuar ALUMNI. Formularët-tip të anketimit, edhe në këtë rast përgatiten nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Të dhënat që vijnë nga anketimet vlerësohen dhe nxirren konkluzione dhe masa konkrete në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së programit si dhe komponentëve të tjerë që lidhen me aspektet e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca , Evidenca 16, Evidenca 16.1, Evidenca 16.3, Evidenca 62.2, Evidenca 63</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e Programit Bachelor në “Siguria dhe Hetim” ka parashikime që mundësojnë transparencën dhe dhënien e mendimit të studentëve në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Vlerësimi përfundimtar është një tërësi e vlerësimeve ndaj angazhimeve në raport me lëndën gjatë gjithë kohëzgjatjes së semesrit. Përpara hyrjes në provim, studentët janë njohur me vlerësimet e provimeve të pjesshme, detyrave të kursit si dhe vlerësimet e tjera gjatë semesrit. Studentët kanë mundësinë e ankimimit si për shkëlqen e rregullave procedurale, ashtu edhe për rezultatin e vlerësimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit. Nëse Përgjegjësi i Departamentit nuk mund ta zgjidhë kërkesën, me miratimin e Dekanit, ngrihet një komision prej tre pedagogësh për vlerësimin e tezës, i cili jep vendimin përfundimtar. Pyetësorët e vënë në dispozicion për studentët kanë edhe elementë që lidhen me procesin e vlerësimit të dijeve, ku studentët mund të shprehin mendimin e tyre në lidhje me këtë proces.</p> <p><i>Evidenca 13</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-AS garanton dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje si dhe dhënien e mendimit të tyre nëpërmjet përfaqësimit në organet vendimarrëse të institucionit.</i></p> <p><i>-Mekanizmat përkatës që mundësojnë përfaqësimin e studentëve në vendimarrje apo vlerësimin e procesit akademik funksionojnë realisht dhe janë në shërbim të studentit, si dhe në funksion të mbarvajtjes së procesit mësimor.</i></p> <p><i>-Studentët e shprehin mendimin e tyre edhe nëpërmjet mekanizmave të tërthortë si pyetësorët e studentëve apo pyetësorët ALUMNI nëpërmjet të cilave ata japin kontributin e tyre në vlerësimin dhe përmirësimin e programit mësimor.</i></p>

*Adela Mendonça*

*JR*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka vënë në dispozicion disa struktura të cilat në kuadrin e aktiviteteve të tyre, mundësojnë edhe nformimin dhe shërbimin ndaj studentëve. Struktura të tilla janë Sekretaria Mësimore, si dhe vetë Departamenti si njësi përgjegjëse për administrimin e procesit akademik. Njëkohësisht studentëve të strehuar në mjediset e AS u sigurohet mbështetje edhe pas mbarimit të procesit mësimor, nëpërmjet strukturave të tilla si Sektori i Disiplinës dhe Sigurisë. <i>Evidenca 51</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Ndonëse nuk ka një strukturë të posaçme për informimin e studentëve, në nivel fakulteti mundësohet informimi, këshillimi dhe mbështetja gjatë gjithë procesit mesimor. Kjo realizohet nëpërmjet përfaqësuesve nga personeli akademik të caktuar nga Departamentet (kapitenët) të cilët mbështesin dhe asistojnë vazhdimisht studentët për çështje që lidhen me procesin mësimor. Në nivel departamenti, në kuadrin e analizës vjetore realizohen statistika mbi pjesëmarrjen e studentëve në programin e studimit, si dhe kalueshmërinë dhe notën mesatare për secilën lëndë/modul.  <i>Evidenca 48</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit ka një sistem të këshillimit dhe mbështetjes së studentëve i cili shtrihet deri në nivelin e Departamenteve. Ndonëse nuk ka një zyrë të posaçme të këshillimit dhe karrierës, nga vizita në institucion GVJ u informua se pranë çdo departamenti caktohet një pedagog për mbajtjen e marrëdhënieve me studentët (kapiteni).  Departamentet si njësitë përgjegjëse ofrojnë në mënyrë të vazhdueshme, mbështetje informim dhe orientim në lidhje me procesin mësimor dhe komponentë të tjerë të programit të studimit. Në zhvillimin e praktikës profesionale meret edhe opinioni i studentëve. Caktimi i praktikës për studentët, merr në konsideratë edhe vendbanimin dhe vendin e punësimit të




orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	studentëve. Departamenti mbikqyr procesin e praktikës profesionale, nëpërmjet pedagogëve të caktuar si dhe udhëzon dhe orienton studentët gjatë kohëzgjatjes së zhvillimit të praktikës. <i>Evidenca 7, Evidenca 7.1</i>
--	--

<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Si pjesë e strukturës së Policisë së Shtetit, institucioni ndjek vijimin e karrierës së studentëve të diplomuar në këtë program studimit. Kjo do të thotë që studentit ndiqet jo vetëm gjatë vazhdimësisë së programit por edhe pas përfundimit të tij. AS asiston studentët e diplomuar në vijimin e karrierës së tyre profesionale dhe nëpërmjet trajnimeve apo aktiviteteve shkencore që kryehen në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit. Ky proces realizohet edhe nëpërmjet strukturave të tjera të dedikuara pranë Policisë së Shtetit. Në këtë mënyrë sigurohet mbajtja e kontakteve me studentët edhe pas diplomimit si dhe ndjekja e karrierës së tyre. AS mundëson edhe tërheqjen e mendimit të studentëve të diplomuar në lidhje me aspekte që i referohen procesit akademik dhe programit të studimit, nëpërmjet pyetësorëve ALUMNI.  <i>Evidenca 19, Evidenca 19.1, Evidenca 46</i>
--	---

<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Ndonëse nuk ka një strukturë të posaçme për informimin e studentëve, institucioni mundëson informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë procesit mesimor.</i></p> <p><i>-Institucioni orienton studentët mbi aspektet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mesimor si dhe zhvillimin e praktikave profesionale.</i></p> <p><i>-AS si pjesë e strukturës së Policisë së Shtetit, mban kontakte me studentët, ndjek në vazhdimësi karrierën policore të studentëve të diplomuar si dhe nëpërmjet trajnimeve kontribuon pas diplomimit në rritjen profesional të tyre.</i></p>
--------------------	---

Shkalla e përmbushjes së standardit				
	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V				
	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

*[Signature]*

*[Signature]* 75

**Standardi VI.1**

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>AS ka hartuar një sërë dokumentash nëpërmjet të cilave vlerëson dhe monitoron cilësisë në nivel institucional. Cilësia dhe metodat e mësimdhënies janë një nga komponentë që i nënënshtrohen vlerësimit dhe monitorimit. Hartimi i dokumentave të tillë në nivel institucional, ndihmon në harmonizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një nga objektivat strategjike të institucionit.</p> <p>Me qëllim realizimin e këtij objektivi, një rëndësi e veçantë i është dhënë rritjes së kapaciteteve profesionale të personelit akademik nëpërmjet organizimit të trajnimeve dhe aktiviteteve që synojnë rritjen e cilësisë me qëllim që stafi mësimdhënës të jetë në kontakt të vazhdueshëm me përvojat operacionale të strukturave të Policisë. Zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme për pëmirësimin e programit dhe kurrikulave ka qënë objekti i trajnimeve të zhvilluara edhe me partnerët ndërkombëtarë dhe mbështetjen nëpërmjet programeve të tilla si Projekti PAMECA V dhe programi ICITAP. Në strategjinë zhvillimore të institucionit pasqyrohet vizioni për qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të arsimimit, kërkimit, trajnimit dhe kualifikimit policor në fushën e sigurisë publike.</p> <p><i>Evidenca 2, Evidenca 55, Evidenca 56, Evidenca 60.3</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>AS përdor një sërë metodash dhe ka ngritur struktura me qëllim monitorim e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës të personelit akademik. Rritja e performancës së personelit akademik, të aftë për të gjeneruar dhe shpërndarë njohuri bashkëkohore në fushën e policimit dhe sigurisë, në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore, duke dhënë kontribut domethënës në fushën e rendit dhe sigurisë publike; është një nga prioritetet e institucionit.</p> <p>Për këtë qëllim janë ngritur dhe funksionojnë një sërë procedurash të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, si raportimi vjetor, nga niveli institucional deri në nivel departamentesh. Ky proces monitorohet dhe vlerësohet edhe përmes instrumenteve të ndryshme sic janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- vlerësimi në auditor i stafit akademik nga drejtuesit e njësive (dekani, përgjegjësi i departamentit);</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerësimi nga studentët nëpërmjet pyetësorëve;</li> <li>- rezultatet e raporteve të NJSBC-së;</li> </ul> <p>Institucioni ka institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe aktet rregullatore të tij. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga objektivat strategjikë në nivel institucional. Për këtë qëllim janë hartuar strategji për sigurimin e cilësisë, plane veprimi si dhe manuale për sigurimin e cilësisë, të cilat parashikojnë objektiva dhe hapa konkret në drejtëm të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Një nga kriteret e vlerësimit të stafit akademik ku bazohet metodologjia e vlerësimit është përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Të dhënat analitike të vlerësimeve të anketimit, në mënyrë të përmbledhur i bëhen të njohura gjithë stafit akademik. Në analizën e tij vjetore të punës stafi akademik nxjerr konkluzione mbi aspekte që i referohen procesit të mësimdhënies gjatë viti akademik të marrë në analizë si dhe hapat për përmirësim.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca, Evidenca 58.1, Evidenca 61, Evidenca 62-62.2</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar strategji zhvillimore si dhe ka ngritur mekanizma dhe procedura të mbikqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë të mësimdhënies dhe performancës së personelit akademik. Një nga format e vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse janë pyetësorët e studentëve. Monitorimi realizohet nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar me studentët si dhe pyetësorëve të zhvilluar me ish-studentët. Nëpërmjet këtyre pyetësorëve vlerësohet si cilësia e programeve të studimit, ashtu edhe performanca e pedagogëve. Rezultatet që vijnë nga pyetësorët përpunohen dhe shërbejnë për të nxjerrë konkluzione konkrete në lidhje me cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mekanizmat e ndërhyrjes për përmirësimin e cilësisë. Formularët e vlerësimit të stafit akademik nga studentët, ruajnë anonimat dhe studentët kanë mundësi të bëjnë vlerësimin e tyre dhe komente të ndryshme. Njëkohësisht përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë mundësohet nëpërmjet kontributit të tyre në veprimtarinë e NJSBC.</p> <p><i>Evidenca 16, Evidenca 16.1, Evidenca 33, Evidenca 33.1</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin</p>	<p>Pranë institucionit është ngritur dhe funksionon NSBC-ja, si strukturë që mundëson mbledhjen e rezultateve nga instrumentat e vlerësimit të procesit mësimor. Këto rezultate</p>

<p>e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>i bëhen të njohura strukturave përkatëse. Më tej ato bëhen object i diskutimeve, analizave dhe shkëmbimit të ideve, që zhvillohen brenda departamenteve. Rezultatet që vijnë nga procesi i vlerësimit të cilësisë si dhe masat që reflektojnë këto rezultate pasqyrohen në analizat e punës vjetore të departamenteve.</p> <p>Më tej, ato reflektohen në analizat që hartohen në rang institucioni ku pasqyrohen edhe politikat për përmirësimin e cilësisë. Institucioni i pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumenta konkretë strategjikë si dhe i konkretizon në plane veprimi që kanë një sërë parashkimesh mbi monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë. Në nivel institucional organet drejtuese të institucionit, në kuadrin e kompetencave të tyre garantojnë zbatimin e politikave dhe strategjive që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 57, Evidenca 58.1, Evidenca 66</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Instucioni i përdor mekanizmat e vlerësimit për të nxjerë konkluzione, ndër të cilat nëpërmjet shembujve pozitivë të nxisë stafin akademik në ritjen e vazhdueshme të cilësisë të mësimdhënies. Raste që gjykohen si pozitive përgjatë procesit të mësimdhënies evidenton në mënyrë të vazhdueshme dhe bëhen të njohura për anëtarët e tjerë. Në këtë mënyrë stafi akademik nxitet pozitivisht në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë përgjatë gjithë procesit akademik.</p> <p>Këtij qëllimi i shërbejnë edhe masat e marra për garantimin e cilësisë dhe promovimin e praktikave më të mira me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit akademik në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për këtë qëllim stafi akademik i këtij program studimi është trajnuar nga partnerë të huaj me financime të BE si dhe nëpërmjet projekteve të binjakëzimit me instiucione analoge të vendeve të tilla si Finlanda, Estoni etj.</p> <p><i>Evidenca 22.1, Evidenca 48, Evidenca 53.1, Evidenca 56</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-AS vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore të institucionit si dhe publikon rezultatet e vlerësimit të kryer.</i></p> <p><i>-Institucioni mundëson mekanizma dhe procedura të mbikqyrjes dhe vlerësimit periodik të cilësisë të mësimdhënies dhe performancës së personalit akademik.</i></p> <p><i>-Për monitorimin e brendshëm të cilësisë të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, Institucioni përdor metodologji</i></p>

*Asim Arifaj*

*[Signature]*

	<i>vlerësimi si dhe instrumente matëse dhe vlerësuese ndër të cilat dhe anketimet e studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>AS-ja si institucion i arsimit të lartë, është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni ka institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me kriteret e standarteve shtetërore të cilësisë dhe aktet ligjore në fuqi. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet strukturave hierarkike organizative të brendshme të AS-së, në nivel institucioni dhe njësie kryesore, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për përmbushjen e tij. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga objektivat strategjikë në nivel institucional.</p> <p>Në funksion të këtij objektivi janë hartuar strategji për sigurimin e cilësisë, plane veprimi si dhe manuale të cilësisë, të cilat parashikojnë hapat konkretë për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm në përputhje me standartet e kërkuara të cilësisë. Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBC në kuadër të misionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore shkencore planifikon veprimtarinë e saj, si dhe harton plane veprimi për realizimin e aktiviteteve.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 59, Evidenca 60, Evidenca 60.1-60.3, Evidenca 61.2-61.6</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji</p>	<p>Institucioni ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për sigurimin e cilësisë duke mundësuar një sistem funksional të sigurimit të cilësisë. Në përputhje me rregullimet institucionale janë ngritur dhe funksionojnë mekanizmat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Institucioni ka ngritur një strukturë të</p>

*Arben Arduçaj*

*[Signature]* 79


<p>institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>brendshme të cilësisë (NJSBC), e cila në përbërjen e saj në cilësinë e anëtarit ka edhe një student. NJSBC si struktura kryesore e sigurimit të cilësisë mbikqyr standartet e brendshme të cilësisë, propozon ndryshime në drejtim të rritjes së cilësisë, si dhe vlerëson efektivitetin e veprimtarive mësimore-kërkimore të institucionit, mundëson mbledhjen e rezultateve nga instrumentat e vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Pranë institucionit është ngritur dhe funksion edhe Komisioni i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Në nivel Fakulteti janë ngritur gjithashtu dhe funksionojnë struktura të vlerësimit të cilësisë. Institucioni ka hartuar dhe zbaton një strategji zhvillimi ku pasqyrohet vizioni mbi një qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të arsimit, kërkimit, trajnimit dhe kualifikimit policor në fushën e sigurisë publike. Me qëllim konkretizimin dhe zbatimin praktik të detyrimeve ligjore në fushën e cilësisë, është hartuar Rregullore “Për sigurimin e brendshëm të cilësisë” si dokumenti themelor, në të cilin përcaktohen parimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, struktura, organizimi, funksionet dhe marrëdhëniet reciproke të subjekteve në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, procedurat e vlerësimit të brendshëm të veprimtarisë akademike/mësimore, kërkimit shkencor dhe të veprimtarive administrative e financiare, si dhe dokumentacioni për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në Akademinë e Sigurisë. Kjo rregullore synon garantimin dhe rritjen e cilësisë së procesit akademik e atij kërkimor në nivel institucional. Manuali i Cilësisë gjithashtu përcakton objektivat e sigurimit të cilësisë, politikat për sigurimin e cilësisë si dhe proceset e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 2, Evidenca 60, Evidenca 60.3.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në AS, si një institucion i arsimit të lartë, realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. AS-ja si institucion i arsimit të lartë dhe programet e studimit që ajo ofron, i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. Akademia e Sigurisë është krijuar me VKM nr.185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”. Me Urdhërin nr.180, datë 15.04.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve është riorganizuar si institucion arsimor.</p> <p>Me V.K.M nr 881, datë 28.10.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si institucioni i vetëm publik i</p>

*Armed Arndeci*

*AR* 80



<p>cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike si dhe organizmin dhe funksionimin e saj”, kësaj Akademie i është dhënë stausi i veçantë si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike.</p> <p>Diploma e programit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me Urdhër të MASR nr.3479/3 datë 13.11.2018.</p> <p>Në përputhje me detyrimet ligjore, institucioni ka kërkuar ti nënënshtrohet instrumentave të vlerësimit të jashtëm të cilësisë nëpërmjet procesit të akreditimit. AS ka plotësuar procedurat për akreditim institucional pranë strukturave përkatëse (ASCAL). Si pjesë e programeve të ofruara nga AS, programi i studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi” gjithashtu ka kaluar në procedurat e vlerësimit periodik të brendshëm të cilësisë. Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive. Institucioni ka një strategji në funksion të përmirësimit vazhdues të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1 Statuti, Evidenca 11, Evidenca 12, Evidenca 12.1</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies dhe programeve të studimit është një nga komponentët që i referohet Sistemit të Brendshëm të Cilësisë. Një nga detyrat e NJSBC është garantimi i cilësisë së brendshme të programeve që ofrohen prej AS, në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Kjo njësi bën vlerësimin në vazhdimësi të programeve që ofrohen nga AS-ja nëse janë në përputhje me standardet e cilësisë, si dhe koherencën e tyre. Njëkohësisht departamentet si njësitë bazë përgjegjëse, zbatojnë instrumente për realizimin e cilësisë së procesit mësimdhënës dhe programeve të studimit. Raportet periodike të vlerësimeve të kryera nga njësitë për matjen e cilësisë së veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, përdoren për ndryshime e përmirësime të cilësisë dhe si bazë për hartimin e kërkesave për akreditimin. Staf i akademik njihet dhe përditësohet mbi sistemin e cilësisë si dhe tërhiqet mendimi i personelit akademik në këtë drejtim. Raportet përfundimtare reflektojnë edhe rezultatet që vijnë nga feedbacku i strukturave përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 3, Evidenca 61, Evidenca 61.2</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-AS ka ngritur mekanizma për sigurimin e cilësisë si dhe zbaton metodologji për të siguruar në mënyrë efektive funksionimin e sistemit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.</i></p>

	<p><i>-Institucioni i pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumenta strategjikë si dhe i konkretizon në plane veprimi që kanë një sërë parashkimesh mbi monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>-Vlerësimi i programit të studimit bëhet në kuadrin e strukturave institucionale të vlerësimit të cilësisë.</i></p> <p><i>-Në nivel institucional organet drejtuese të institucionit, në kuadrin e kompetencave të tyre garantojnë zbatimin e politikave dhe strategjive që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse</p>	<p>AS vendos në përdorim një sërë mekanizmesh për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit mësimor Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”. Rregulloret dhe akte të tjera të posaçme të institucionit kanë parashikuar procedurat për miratimin, rishikimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve si dhe kompetencat e strukturave përgjegjëse në këtë drejtim.</p> <p>Departamentet si njësia përgjegjëse për zbatimin e programit iniciojnë ndryshimet dhe përmirësimet e kurrikulës me qëllim përshtatjen me risitë e reja shkencore. Më tej vendimmarja vijon në strukturat e tjera akademike deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik. Mbikëqyrja e programit të studimit është pjesë e proceseve të vlerësimit periodik në kuadrin e vlerësimit në tërësi të cilësisë. Institucioni ka përdorur si metodologji vlerësimi anketimet që japin rezultate në lidhje me vlerësimin e studentëve mbi programin e studimeve. Rezultateve e anketimeve të studentëve për secilën nga syllabuset përkatëse janë pjesë e vlerësimit periodik të programit. Në nivel institucional, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, si dhe për organizimin dhe vlerësimin e projekt - programeve të studimit</p>


<p>dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>të ciklit të pare dhe të dytë, në nivel njësie bazë, të paraqitura sipas parashikimeve të statutit. Nga vizita në vend si dhe nga studimi i dokumentacionit, rezulton se Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, bazuar në metodën SWOT, (raporti i RVB) si dhe instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre, duke kombinuar metodën e tërthortë me atë të drejtëpërdrejtë.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 14, Evidenca 14.1, Evidenca 60-60.3</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sistemi i vlerësimit të programit të studimit shtrihet nga departamentet si njësitë përgjegjëse për zbatimin e tij, deri tek strukturat më të larta akademike. Departamentet në raportet vjetore pasqyrojnë gjetjet në lidhje me rezultat e vlerësimit të programit të studimit, mangësitë, si dhe adresojnë rekomandimet për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Më tej, të njëjta qëndrime reflektohen edhe në raporte vjetore të hartuara në nivelin e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit. Në kuadër të vetvlerësimit institucional, RVB pasqyron rezultatet e vlerësimit dhe mbikqyrjes së programeve të studimit, si dhe evidenton aritjet më të mira dhe rezultatet e përputhshmërisë së programeve të studimit me standartete e cilësisë dhe propozon masat për përmirësim. Rezultatet që vijnë nga procesi i vlerësimit të programit të studimit në kuadrin e vetvlerësimit të brendshëm të cilësisë i bëhen të njohura Departamentit dhe stafit akademik të cilët reflektojnë qëndrimet e tyre për përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 5, Evidenca 61.1, Evidenca 65.1, Evidenca 66</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e</p>	<p>Me qëllim vlerësimin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, AS i referohet një sërë procedurash dhe metodash si të drejtëpërdrejta, ashtu edhe të tërthorta. Për të vlerësuar mbarëvajtjen e programit të studimit, shkallën e të nxënësve dhe rezultatet e studentëve, janë përdorur metoda të drejtëpërdrejta si vlerësimi në auditor, testime paraprake dhe përfundimtare, vlerësimi i detyrave të kursit dhe praktikës. Programet e lëndëve/moduleve kanë të pasqyruar qartë komponentët që lidhen me kontrollin e dijeve, mënyrën e vlerësimit, detyrimet e studentit në auditor dhe orët e punës individuale jashtë auditorit. Në përfundim të programit studentët i nështrohen një provimi përfundimtar si kusht për marjen e diplomës në programin bachelor në “Siguria dhe Hetimi”.</p> <p>Për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies si dhe shkallën e përgatitjes së studentëve, institucioni i referohet edhe</p>

<p>arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>metodave të tjera si zhvillimi i leksioneve të hapura, vëzhgimi i zhvillimit të mësimit në auditor me pjesëmarrje nga kolegët, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani. Këto të fundit i referohen kryesisht stafit akademik të kategorisë “lektor”, ose “asistentlektor”.</p> <p><i>Evidenca RVB tabela 14, Evidenca 3.1, Evidenca 7, Evidenca 7.1, Evidenca 13</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutura nga ky program.</p>	<p>Programet mësimore në AS i në shtrohen procesit të vlerësimit periodik, mbikqyrjes dhe përditësimit nëpërmjet përdorimit të procedurave dhe instrumentave të tërthorta. Në kuadrin e metodave të tërthorta të përdorura në procesin e vlerësimit të programit të studimit, AS ka përdorur si metodologji vlerësimi edhe anketimet e studentëve që janë në vijim të programit të studimit. Nëpërmjet anketimeve tërhiqet mendimi i studentëve mbi procesin mësimor si dhe programin e studimit. Përveç të tjerash, anketimet i referohen edhe vlerësimit të procesit të mësimdhënies si dhe përmbajtjes së kurrikulës.</p> <p>Me qëllim monitorimin periodik të cilësisë së programit, anketimet bëhen në mënyrë periodike, çdo semestër. Rezultatet e anketimeve janë pjesë e raporteve të vlerësimit të brendshëm institucional. Rezultatet e tyre përcillen në Departamente dhe struktura të tjera përkatëse, me qëllim reflektimin mbi rezultatet dhe marjen e masave të nevojshme për përmirësim.</p> <p>AS mban kontakte të ngushta edhe me studentët e diplomuar edhe pas përfundimit të studimeve. Ky proces lehtësohet për shkak të faktit se të diplomuarit në këtë program studimi janë të angazhuar pranë strukturave të Policisë së Shtetit. Si pasojë, procesi i gjurmimit është më i thjeshtë dhe mundëson përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe rivlerësimit të kurikulave nëpërmjet anketimeve. Kjo veprimtari realizohet përmes strukturave të dedikuara për të realizuar këtë objektiv të institucionit. Prosesi i vlerësimit të cilësisë mundësohet edhe përmes instrumenteve të tjerë sic janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vetvlerësimi i stafit akademik;</li> <li>- vlerësimi i stafit akademik nga drejtuesit e njësive (dekani, përgjegjësi i departamentit);</li> </ul> <p>Institucioni i ka përdorur këto instrumenta si metodologji vlerësimi të performancës dhe mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 16, Evidenca 16.3, Evidenca33, Evidenca 33.1, Evidenca 57, Evidenca 62-62.2.</i></p>





<b>Konkluzione</b>	<p>-AS ka hartuar dhe zbaton strategji që kanë si pjesë të objektivave edhe vlerësimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>-Në zbatim të objektivave strategjike, janë përdorur një sërë instrumentash e metodologjish vlerësimi të mbarëvajtjes dhe cilësisë të programit të studimit</p> <p>-Për kryerjen e vlerësimit, institucioni ka përdorur si metodat e drejtëpërdrejta, ashtu edhe metodat e tërthorta që japin rezultate në lidhje me vlerësimin e programit të studimeve.</p> <p>-Rezultatet e vlerësimit janë pjesë e raporteve të brendshme të vlerësimit dhe ndikojnë në ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve që ndjekin programin e studimeve mbi rëndësinë e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>


<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Vënia në zbatim e politikave dhe procedurave të vlerësimit të cilësisë është mundësuar nëpërmjet përfshirjes së një sërë aktorësh si dhe aksesimit të kontributeve të tyre në vlerësimin e cilësisë. Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ka përfshirë një sërë komponentësh të brendshëm, si personelin akademik, ndihmës administrativ dhe studentët.</p> <p>Për sa i takon aktorëve të jashtëm, është mundësuar përfshirja e studentëve ALUMNI si dhe kontributi i tyre në përmirësimin e vazhduar të cilësisë. AS ka finalizuar partneritetin në projekte të rëndësishme që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë, nëpërmjet të cilave është mundësuar shkëmbimi i përvojave në fushën studimore dhe kërkimore si dhe njohja me qasjet e reja të metodologjisë dhe instrumenteve të monitorimit të cilësisë (Projekti i “Teinining project: strengthening the capacities and efficiency of the Security Academy - Albania”).</p> <p>Në kuadrin e masave për sigurimin e cilësisë institucioni ka hartuar strategjinë e tij zhvillore. Nëpërmjet kësaj strategjia AS synon një qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të</p>




	<p>arsimimit, kërkimit, trajnimit dhe kualifikimit policor në fushën e sigurisë publike. Për hartimin e kësaj strategjie është mundësuar pjesëmarrja e ekspertëve të huaj. Ky bashkëpunim është mundësuar në kuadrin e projektit “Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë - TËINNING IPA 2018”. <i>Evidenca 2, Evidenca 18, Evidenca 18.1</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në aktet e brendshme regullatore të AS përcaktohen kompetencat si dhe roli i secilës nga strukturat e angazhuara në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këto akte janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e këtyre strukturat në ushtrimin e kompetencave dhe zbatimin e detyrave të tyre. Në aktet rregullatore është parashikuar ngritja e NJSBC si strukturë e brendshme e cilësisë në nivel institucional, e cila realizon procesin e vlerësimit periodik të cilësisë. Kjo strukturë bashkëpunon me njësi të tjera në nivelin e njëjësive kryesore dhe njësisë bazë me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 58.2, Evidenca 59, Evidenca 61.2-61.5</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Departamentet si njësitë bazë dhe Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit si njësa kryesore ushtrojnë kompetencat e tyre në procesin e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë të programit të studimit. Departamentet si njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, hartojnë dhe përditësojnë syllabusat e lëndëve duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Përmirësimi i syllabuseve realizohet nga stafi akademik, si ne lidhje me literaturën, ashtu dhe me temat e programit mësimor me qëllim azhornimin me risitë shkencore. Aktet regullatore të institucionit sanksionojnë rolin e departamenteve si njësitë përgjegjëse kryesore për këtë programin e studimit, si dhe atë të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, studentëve në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Vlerësimi i programit të studimit përfshin si departamentet, ashtu edhe Fakultetin si dhe strukturat më të larta akademike. Raportet vjetore pasqyrojnë problematikat mbi rezultat e vlerësimit të programit, si dhe masat për përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidenca RVB tabela 14, Evidenca 3, Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të programit të studimit respekton parimin e barazisë dhe integritetit akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personalit akademik. Në përzgjedhjen e anëtarëve, strukturave përgjegjëse për procesin e monitorimit e të vlerësimit të cilësisë marren në konsideratë</p>





<p>çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>kriteret që lidhen me kompetencat profesionale dhe parimin e paanshëmrisë duke evituar çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në proces. Njëkohësisht parimi i kolegjalitetit në vendimmarrje eviton anshmërinë dhe garanton të drejtën e secilit anëtar për shprehjen e lirë të vullnetit.</p> <p><i>Evidenca 3, Evidenca 3.1, Evidenca 59, Evidenca 59.1, Evidenca 65</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në kuadrin e angazhimit të stafit akademik në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, është mundësuar edhe angazhimi i pedagogëve të jashtëm. Pedagogët e jashtëm të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Siguria dhe Hetimi”, ishin pjesë e takimit të zhvilluar nga GVJ me personelin akademik.</p> <p>Ata shprehën qëndrimet dhe opinionet e tyre në lidhje me aspekte që i referohen përmirësimit të brendshëm të cilësisë dhe programit të studimit. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, mbajnë kontakt të vazhdueshëm me AS, dhe kontribuojnë me ekspertizë profesionale për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit të zhvilluara pranë AS. Partneriteti i AS në projekte ndërkombëtare ka mundësuar ekspertizë edhe në çështje që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 18, Evidenca 18.1</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Zbatimi i politikave dhe procedurave të vlerësimit të cilësisë në AS mundëson përfshirjen e një sërë aktorësh të brendshëm dhe të jashtëm si dhe aksesimin e kontributeve të tyre në vlerësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>-Aktet e brendshme regullatore të AS përcaktojnë kompetenca dhe përgjegjësi konkrete për të gjithë palët e angazhuara në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të këtyre kompetencave.</i></p> <p><i>-Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të programit të studimit respekton parimin e barazisë dhe integritetit akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>




**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtaritë e monitorimit që realizohen në kuadrin e procesit të vlerësimit të cilësisë respektojnë procedurat si dhe parimet e parashikuara në strategjitë zhvillimore, manualët e cilësisë dhe aktet të tjera rregullatore. Bazuar në parimin e transparencës ato u bëhen të njohura strukturave drejtuese nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit.</p> <p>Departamentet reflektojnë konkluzionet e raporteve të vlerësimit si dhe marrin masa për përmirësim në kuadrin e përgjegjësisë të tyre. Studentët informohen nga pedagogët në lidhje me aspekte të mbarëvajtjes së programit të studimit. Nga takimi me studentët rezultoi se ata ishin të informuar, për ekzistencën e strukturave të brendshme të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 2, Evidenca 60.3, Evidenca 60, Evidenca 60.1, Evidenca 60.2</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit bëhen të njohura nëpërmjet procedurave që respektojnë parimet e etikës akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. Institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Rezultatet që dalin nga procesi i vlerësimit të cilësisë të programit të studimit u komunikohen strukturave përkatëse nëpërmjet korespondencës shkresore.</p> <p>Për këtë qëllim, në nivel institucional është ngritur dhe funksionon edhe NJSBC, si strukturë që mundëson mbledhjen e rezultateve të vlerësimit të programit mësimor. Pjesë e këtyre instrumentave janë edhe pyetësorët e studentëve si dhe vlerësimet për personelin akademik. Shpërndarja e pyetësorëve bëhet fizikisht ose “on line”. Rezultatet e këtyre të fundit bëhen të njohura duke respektuar etikën akademike dhe ruajtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca RVB, Evidenca 60, Evidenca 50.1, Evidenca 59</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>	<p>Të dhënat mbi rezultatet e vlerësimit, pas komunikimit dhe bërjes publike i nështrohen procesit të diskutimeve dhe reflektimeve nga aktorët e brendshëm në nivel institucioni. Në raportet e vlerësimit të brendshëm pasqyrohen dhe mangësitë dhe problematikat që evidentohen nga vlerësimi i brendshëm i</p>






<p>mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>cilësisë. Problematikat u bëhen të njohura pedagogëve dhe strukturave të tjera me qëllim reflektimin për përmirësimin e mangësive të evidentuara. Të gjitha strukturat pasi njihen me rezultatet e vlerësimit duhet të marrin masat të cilat synojnë ndërhyrje konkrete për riparimin e mangësive të konstatuara. Këto masa pasqyrohen edhe në planet e veprimit të cilat hartohen në mënyrë periodike në varësi të nevojave për ndërhyrje dhe përmirësim.</p> <p><i>Evidenca 55, Evidenca 60, Evidenca 60.3, Evidenca 66</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet e përcaktuara në aktet e tij rregullatore, institucioni mundëson efektivitetin e veprimtarive në kuadër të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë të programit të studimit Bachelor në “Siguria dhe hetimi”.</p> <p>Me qëllim vlerësimin e impaktit të veprimtarive të realizuara në kuadrin e cilësisë, AS përfshin në këtë proces një numër sa më të gjerë të strukturave të tij në nivel institucional. Si të tilla janë strukturat e dedikuara ndaj procesit të vlerësimit të cilësisë si NJSBC, apo Komisioni i Kurrikulës. Një sërë strukturash të tjera si departamentet, Drejtuesi i Departamentit, Dekani, Senati Akademik etj, gjithashtu kontribuojnë me veprimtarinë e tyre në vlerësimin e efektivitetit të veprimtarive të realizuara në kuadër të vlerësimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 3, Evidenca 3.1</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni synon informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë të programit të studimit. Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë mundësohet nëpërmjet përfaqësimit të tyre në strukturat institucionale me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë si NJSBC apo Senatit Akademik.</p> <p>Angazhimi i studentëve në këtë drejtim, manifestohet edhe nëpërmjet Këshillave Studentorë ku studentët marrin pjesë aktive si dhe rrisin ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë. Informimi i studentëve si dhe stafit akademik realizohet edhe nëpërmjet publikimit të informacioneve në faqen zyrtare të institucionit apo rrjetet sociale, të cilat gjithashtu ndikojnë në ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e përfshirjes në sigurimin e cilësisë të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1, Evidenca 3, Evidenca 27</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Veprimtaritë e realizuara në kuadrin e procesit të vlerësimit të cilësisë bëhen të njohura për gjithë aktorët e interesuar</i></p>

*Alisa Andej*

*[Signature]*

	<p><i>nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit bazuar në parimin e transparencës.</i></p> <p><i>-Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit realizohet nëpërmjet procedurave që respektojnë parimet e etikës akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p> <p><i>-Me qëllim vlerësimin impaktin të veprimtarive të realizuara në kuadrin e cilësisë, AS përfshin në këtë proces një numër sa më të gjerë të strukturave të tij në nivel institucional.</i></p> <p><i>-Institucioni zbaton procedura që mundësojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë të programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Siguria dhe Hetimi”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Akademia e Sigurisë është institucioni i vetëm i arsimit të lartë në vend që ofron programe të formimit të punonjësve të strukturave të policisë së shtetit dhe të ngjashme me to;
2. Statusi i veçantë i Akademisë së Sigurisë është një premisë pozitive në funksion të përmbushjes me sukses të programit mësimor si dhe potencialit të punësimit të garantuar të studentëve pranë strukturave të Policisë së Shtetit;
3. Institucioni, i cili ofron programin e studimit, objekt vlerësimi, ka një përvojë të konsoliduar në drejtim të ofrimit të programeve të ciklit të parë të studimeve, përvojë e cila është element kyç për të përcaktuar dhe trajtuar problematikat, vështirësitë apo sfidat e ndryshme që mund të lindin gjatë procesit;
4. Institucioni mbështet këtë program dhe të gjithë veprimtaritë e tij akademike, shkencore dhe administrative në një strukturë të organizuar në mënyrë të përpiktë dhe mjaft funksionale;

*[Signature]*

*[Signature]*


5. Personeli akademik i angazhuar në këtë program, ka përvojë të gjatë në institucionet e policisë së shtetit (me shprehi e shkathtësi të larta praktike) apo përvojë të konsiderueshme në sektorin e drejtësisë, përdor metoda efikase të mësimdhënies, gjë e cila duhet parë si një element i rëndësishëm në drejtim të arritjes së objektivave në lidhje me cilësinë e programit të ofruar;
6. Institucioni zotëron ambiente me standarde mjaft të mira për zhvillimin e programit të studimit, të pajisur me mjetet e duhura nga pikëpamja logjistike;
7. Institucioni ka hartuar një kuadër rregullator të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim;
8. Sistemi i bashkëpunimit me institucione akademike homologe vendase dhe të huaja, si dhe pjesëmarrja në projekte partneriteti me partner ndërkombëtarë në fushën e trajanimeve dhe kualifikimit shkencor është një premisë e rëndësishme për ritjen e standarteve në ofrimin e programit;
9. Akademia e Sigurisë ka ngritur mekanizma efikasë për sigurimin e cilësisë si dhe zbaton metodologji për të siguruar funksionimin e sistemit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit;
10. Institucioni garanton dhe mundëson përfshirjen e studentëve në vendimarrje dhe procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe dhënien e mendimit të tyre nëpërmjet përfaqësimit në organet vendimarrëse të institucionit;

**b. Pika të dobëta:**

1. Institucioni dhe njësia përgjegjëse që ofron këtë program studimi, nuk kanë në përdorim një platformë antiplagjiaturë; (*Standardi III.3, kriteri 5*)
2. Fondi fizik dhe ai dixhital i bibliotekës që i referohen programit të studimit, ka nevojë të rrisë kapacitetin në përshtatje me nevojat e programit për literaturë bashkohore dhe zhvillimet e reja shkencore; (*Standardi IV.3, kriteri 4*)
3. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit nuk ka pjese perberese te tij platforma elektronike të dedikuara për shkëmbimin e informacionit midis personelit akademik dhe studentëve në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor; (*Standardi IV.4, kriteri 4*)

**Rekomandime**

1. Institucioni dhe njësia kryesore ku ofrohet ky program, duhet të caktojë një koordinator të programit të studimit, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale;
2. Institucioni duhet të sigurojë që stafi akademik të mbështetet më shumë nga strukturat përkatëse akademike për botimin e teksteve në funksion të programit të studimit, pasi në këtë profil nuk ka shumë literaturë në gjuhën shqipe;
3. Rifreskimi periodik me literature bashkëkohore vendase dhe të huaj në varësi të zhvillimeve të reja shkencore të fushës që mbulon lënda/moduli;
4. Kapacitetet e bibliotekës duhet të rriten nëpërmjet pasurimit të fondit fizik dhe rritjes së aksesit në bibliotekat on-line që i referohet programit të studimit në funksion të nevojave për kërkim shkencor të studentëve dhe stafit akademik;




5. Duhet të shihen mundësitë që analizat lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit, të përfshihen në planin e punës së NJSBC-së;
6. Institucioni si dhe njësia bazë duhet të marrin masa me qëllim rishikimin e syllabuse-ve për të përfshirë në ta më shumë detaje mbi kriteret e vlerësimit të secilit komponent si dhe më shumë udhëzime mbi aktivitetet e punës në grup dhe kriteret e vlerësimit të pjesëmarrjes aktive;
7. Institucioni duhet të marrë masa konkrete për ngritjen e një sistemi të efektshëm antiplagjiaturë;
8. Sistemi i manxhimit të informacionit të paiset me platforma elektronike për të mundësuar komunikimit interaktiv në kohë reale dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve;

**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in:  
"Security and Investigation"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. The Security Academy is the only institution of higher education in the country that offers training programs for employees of the state police and similar structures;
2. The special status of the Security Academy is a positive premise for the successful completion of the study program as well as the potential of the guaranteed employment of students in the State Police;
3. The institution, which offers the study program, object of assessment, has a consolidated experience in terms of offering programs of the first cycle of studies, experience which is a key element to define and deal with the various problems, difficulties or challenges that can arise during the process;
4. The institution supports this program and all its academic, scientific and administrative activities in a structure organized in a precise and functional way;
5. The academic personnel engaged in this program have long experience in the state police institutions (with high practical skills) or considerable experience in the justice sector, use efficient teaching methods, which should be seen as an element important in terms of achieving the objectives related to the quality of the program offered;
6. The institution owns premises with fairly good standards for the development of the study program, equipped with the appropriate tools from a logistical point of view;
7. The institution has drawn up a complete regulatory framework on the criteria and procedures of the academic progress of students during the development of the study program from admission to graduation;
8. The system of cooperation with local and foreign counterpart academic institutions, as well as participation in partnership projects with international partners in the field of training and scientific qualification is an important premise for raising standards in the completion of the study program;
9. . The Security Academy has established efficient mechanisms to monitor internal quality and implements methodologies to ensure the efficient functioning of the internal quality assessment system of the study program;





10. The institution enables the involvement of students in decision-making and the process of internal quality assessment, as well as guarantees the expression of their opinion through their representation in the decision-making bodies of the institution;

**b. Weaknesses:**

1. The institution and the responsible unit offering this study program do not use an anti-plagiarism platform; (*Standardi III.3, criterion 5*)
2. The physical and digital fund of the library that refers to the study program needs to increase the capacity in accordance with the needs of the program for contemporary literature and new scientific developments; (*Standardi IV.3, criterion 4*)
3. The internal information management system does not have electronic platforms dedicated to the exchange of information between academic staff and students, what would help the success of the learning process; (*Standardi IV.4, criterion 4*)

**Recommendations**

1. The institution and the main unit where this program is offered must appoint a coordinator of the study program, responsible for the progress and development of the program and professional practices;
2. Since there is not much literature in the Albanian language in this profile, the institution must ensure that the academic staff is supported more by the relevant academic structures for the publication of texts in relation to the study program;
3. Periodic refreshment with contemporary local and foreign literature depending on new scientific developments in the field covered by the subject/module;
4. The capacities of the library should be improved through the enrichment of the physical fund and the increasing access to the online library which refers to the study program in function of the scientific research needs of students and academic staff;
5. For the analysis of cooperation agreements, it should be considered whether they should be included in the NJSBCs work plan;
6. The institution and the basic unit should take steps to revise the syllabuses in order to include more details on the evaluation criteria of each component, as well as more instructions on group work activities and evaluation criteria of active participation;
7. The institution must take concrete measures for the establishment of an effective anti-plagiarism system;
8. The information management system should be equipped with electronic platforms to enable interactive communication in real time and the exchange of information between academic staff and students;



FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMII PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

*Arbër Pandor*

*[Signature]*